



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në  
“Financë Kontabilitet”  
ofruar nga  
Institucioni i Arsimit të Lartë Kologji Universitar “LOGOS”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


1. Prof. Dr. Drini Salko

2. Prof. Dr. Dorina Kripa

Mars, 2024

**Tabela përmbledhëse për programin e studimit Master Profesional në “Financë Kontabilitet”**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “LOGOS”
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti Ekonomik (FE) dhe Departamenti i Finance Kontabilitetit
3	Emërtimi i programit të studimit:	MP në Finance Kontabilitet
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr.428, datë 22.09.2017..
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati Nr. 1, datë 10.03.2022, konfirmuar me shkresë të MASR Nr. 2380/3 Prot., datë 30.05.2022, ndryshime të cilat hyjnë në fuqi në vitin akademik 2022-2023.
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA nr. 20, dt. 01.03.2022.
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA nr.50, dt.13.07.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	I vit akademik
10	Kreditet në total (ECTS):	60 kredite ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuhe Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2019-2020 5 PAE/ 8 PAK 2020-2021 6 PAE/ 5 PAK 2021-2022 5 PAE/ 8 PAK
18	Numri i studentëve:	2019-2020 18 studente 2020-2021 19 studente 2021-2022 13 studente.
19	Komente / të tjera:	



## PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar "LOGOS" (KUL) është një institucion privat i arsimit të lartë, i licencuar me VKM nr.1055 date 29.07.2009. KUL i është akorduar akreditimi institucional me Vendim Nr. 58, datë 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit të ASCAL, me kohëzgjatje 4 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 15.12.2025. KUL sipas strukturës aktuale ka në përbërjen e tij tre fakultete emërtuar si vijon:

- Fakulteti Ekonomik
- Fakulteti i Shkencave të Aplikuara
- Fakulteti Shkencave Humane dhe Komunikim Gjuhësor

Fakulteti Ekonomik ka në përbërjen e tij tre departamente:

Departamentin e Finance kontabilitetit

Departamentin e Menaxhimit

Departamentin e Agrobiznesit.

Fakulteti Ekonomik (FE) dhe Departamenti i Finance Kontabilitetit janë përkatësisht njësia kryesore dhe ajo baze e programit të studimit të ciklit të dyte Master Profesional në Financë Kontabilitet (MP në FK). Ky program studimi është hapur bazuar në urdhrin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr.335, date 16.08.2013 me kohe të plote dhe me kohëzgjatje një vit akademik që përfshin 60 kredite.

Programi i studimit MP në Finance Kontabilitet është akredituar për here të pare me vendim nr.50 date 13.07.2018 nga ASCAL për një periudhe 5 vjeçare.

Gjate kësaj periudhe në vitin 2022 janë bere disa ndryshime në programin e studimit brenda nivelit të 20 % të lejuar nga kuadri ligjor në fuqi.

Departamenti i Kontabilitet Financës ofron aktualisht dy programe studimi: Bachelor në Financë Kontabilitet i akredituar me vendim të Këshillit të Akreditimit nr. 338 date 08.06.2012 dhe këtë program studimi MP në Financë Kontabilitet

Programi MP në Finance Kontabilitet është përpjekur të reflektojë përvojën më të mirë të programeve Master Profesionalë në financë dhe kontabilitet në vendin tonë. Ky është akreditimi i dytë që do të krijojë mundësinë për përmirësime në vijim, në përputhje të Ligjit Nr.80/2015 të Arsimit të Lartë, udhëzimet që pasuan atë, si dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.

Prioritetet e programit MP në Finance Kontabilitet janë në përputhje të plotë me ato të KUL dhe kanë të bëjnë me suksesin e studentëve në tregun e punës.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

### **Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)**

ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Institucioni, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Dr. Drini Salko dhe Prof. Dr. Dorina Kripa. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Anilda Beqiraj.

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master Profesional në “Financë Kontabilitet”, i ofruar nga Departamenti i Financës Kontabilitet të Fakultetit të Ekonomik pranë KUL, filloi me prezantimin, si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga e-ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita në FE të KUL, u realizua në datën 28 dhe 29 Shtator 2023, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas agjendës së vizitës në IAL. Gjatë vizitës, në FE të KUL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjësen e Departamentit të Financës Kontabilitet dhe Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik të programit të studimit, stafin e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë, Zyrën e Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, si dhe me Sekretarinë mësimore.

GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët, etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas agjendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit MP në KF, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse.

Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vlerësimit të brendshëm, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL, si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitës të realizuar në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL, si më poshtë vijon.



## SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

Programi i studimit MP në Finance Kontabilitet është akredituar për here të pare me vendim nr.50 date 13.07.2018 nga ASCAL me vlerësim Pozitiv për një periudhe 5 vjeçare me rekomandimet e mëposhtme:

**I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.50. datë 13.07.2018 janë:**

- 1. Institucioni të ngrejë dhe garantoje mirëfunksionimin e një sistemi të informatizuar në ndihme të realizimit të programit të studimit*
- 2. Institucioni të marre masa për pasurimin e bibliotekës me periodike dhe tekste në gjuhën shqipe, për mbulimin e plotë të lendeve e moduleve të programit*
- 3. Institucioni në të ardhmen të shoh mundësinë e sigurimit të aksesit të plotë në bibliotekën online të institucionit, edhe jashtë ambienteve të tij.*

**II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni**

**Rekomandim 1:**

- 1. Institucioni të ngrejë dhe garantoje mirëfunksionimin e një sistemi të informatizuar në ndihme të realizimit të programit të studimit**


Gjate 3 viteve të kaluara KUL ka ndërmarre iniciativa në ngritjen e një sistemi të informatizuar në ndihme të stafit dhe studenteve të programit. Nga shqyrtimi i RVB dhe vizita në institucion në evidentuam funksionimin e platformës EDUPAGE krahas asaj Microsoft Teams i futur në përdorim gjate situatës pandemike si dhe gjate viteve të fundit. Platforma është aktive dhe ndihmon stafin dhe studentet në shkëmbimin e informacionit gjate procesit të mësimdhënies dhe mësim nxënies. Sistemi informativ online si dhe faqja zyrtare e institucionit japin informacion në kohe reale për stafin dhe studentet.

**Ky rekomandim është përmbushur plotësisht**

**Rekomandimi 2 dhe 3**

- 2. Institucioni të marre masa për pasurimin e bibliotekës me periodike dhe tekste në gjuhën shqipe, për mbulimin e plote të lendeve e moduleve të programit**
- 3. Institucioni në të ardhmen të shoh mundësinë e sigurimit të aksesit të plote në bibliotekën online të institucionit, edhe jashtë ambienteve të tij**

Bazuar në dokumentacionin e aplikimit dhe vizitën që GVJ beri në bibliotekën e institucionit u evidentua se institucioni ka pasuruar bibliotekën me një fond të pasur literature bashkëkohore në gjuhën shqipe dhe atë të huaj duke plotësuar kërkesat e stafit dhe studenteve për literature. Gjithashtu krahas pasurimit të fondit të bibliotekës me tekste dhe botime periodike stafi dhe



studentet kane mundësi të përdorimit të bazës së të dhënave elektronike të fondit të bibliotekës si dhe akses të bibliotekës online të Universitetit të Piraeus si dhe të bibliotekave online JSTOR dhe EBSCO.

**Këto dy rekomandime janë përmbushur plotësisht**

## **LISTA E SHKURTIMEVE**

<b>ASCAL</b>	<b>Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Larte</b>
<b>DFK</b>	<b>Departamenti i Financë Kontabilitetit</b>
<b>FE</b>	<b>Fakulteti i Ekonomisë,</b>
<b>GVB</b>	<b>Grupi i Vlerësimit të Brendshëm</b>
<b>GVJ</b>	<b>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm</b>
<b>KPSSC</b>	<b>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë</b>
<b>MP</b>	<b>Master Profesional</b>
<b>NJSBC</b>	<b>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</b>
<b>KUL</b>	<b>Kolegji Universitar “LOGOS”</b>
<b>QSHA</b>	<b>Qendra e Shërbimeve Arsimore</b>
<b>RASH</b>	<b>Rrejtji Akademik Shqiptar</b>
<b>RVB</b>	<b>Raport i Vlerësimit të Brendshëm</b>
<b>SBC</b>	<b>Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë</b>
<b>VKM</b>	<b>Vendim i Këshillit të Ministrave</b>

**Kolegji Universitar Logos, është njohur me DRVJ më datë,15.02.2024, përmes sistemit AMS, formë zyrtare me shkresë Nr 121/3 Prot date 15.02.2024. Kolegji dërgon komente me shkresë me Nr 46/1 Prot. datë 22.02.2024. Në këtë mënyrë DRVJ merr formën përfundimtare si RVJ.**



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Financë Kontabilitet”**

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të II-të Master Profesional (MP) në “Financë Kontabilitet”, i ofruar nga Kolegji Universitar “LOGOS” (KUL), Fakulteti i Ekonomisë (FE), Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit (DFK), në të gjithë komponentët e tij nuk bie ndesh me interesat kombëtare por i shërben këtyre të fundit. Si një program në fushën e financës dhe kontabilitetit ai i shërben përgatitjes dhe kualifikimit të studenteve në shërbim të interesave kombëtare në përgjithësi dhe zhvillimit ekonomik të vendit në sektorin financiar.</p> <p>Programi i studimit MP në “Financë Kontabilitet” është hartuar në zbatim të Ligjit në fuqi për Arsimin e Lartë, akteve nënligjore dhe kuadrin rregullues të tij si dhe në Strategjinë e Zhvillimit në KUL 2018-2024. Ky program reflekton vlerat akademike e kulturore, standarde të arsimit të lartë në Shqipëri. Ky vlerësim bazohet në plotësimin e kriterëve thelbësorë të këtij programi në aspektin akademik dhe atë kulturor bazuar edhe në Statutin e KUL (Kreu I, Neni nr.3, Misioni dhe Qëllimi) Parë në tërësi, programi synon përcjelljen tek studentët si të vlerave akademike, ashtu dhe të atyre kulturore në shërbim të sektorit ekonomik të vendit në përgjithësi dhe fushës së financës apo kontabilitetit në veçanti e përcaktuar edhe në rregulloren e këtij programi (neni 3, Mision)</p> <p><i>Shtojca nr.1.Statuti i KUL</i> <i>Shtojca nr.15. Plani Strategjik i KUL 201820-2024</i> <i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe</p>	<p>Programi i studimit MP në “Financë Kontabilitet” është hartuar në mbështetje të qëllimit dhe misionit të KUL-së dhe FE si njësi kryesore e tij, të shprehura në Statutin e KUL (neni nr.3), Strategjinë e Zhvillimit të KUL 2018-2024 si dhe rregulloren e vete</p>



<p>misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>programit të studimit në Financë Kontabilitet me fokus përgatitjen e studentëve me njohuritë bashkëkohore teorike, shkencore dhe praktike në fushën e financës, bankës, kontabilitetit dhe menaxhimit të riskut. në funksion të kësaj strategjie është edhe operimi i njësisë kryesore/bazë të këtij programi, FE dhe DKF si njësi baze që mbulon këtë program. Ky program plotëson më mirë nevojat në fushën e veprimtarisë ekonomike të lidhura me aplikimin e programeve bashkëkohore në fushën e financës dhe kontabilitetit”.</p> <p><i>Shtojca nr.1.Statuti i KUL</i>  <i>Shtojca nr.15. Plani Strategjik i KUL 2018-2024</i>  <i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i>  <i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Financë Kontabilitet” është hartuar në përputhje me Statutin e KUL dhe Planin Strategjik të tij 2018-2024 si dhe në dokumentet baze rregullative të KUL edhe në rregulloren e këtij programi neni 3:objektiva të programit, faqe 2 dhe 3 theksohet pajisja e studenteve me formim akademik shkencor dhe koncepte të thelluara në fushën e financës dhe kontabilitetit. Ky program studimi i hapur me urdhër të MASH nr.335 date 16.08.2013, reflekton synimin e institucionit dhe veçanërisht njësisë bazë të tij, DFK, për të zhvilluar këtë program bazuar në Planin Strategjik të KUL.</p> <p><i>Shtojca nr.1.Statuti i KUL</i>  <i>Shtojca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i>  <i>Shtojca nr.15. Plani Strategjik i KUL 2018-2024</i>  <i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i>  <i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Ky program studimi i shërben zhvillimit kombëtar). Në këtë këndvështrim, ky program studimi, nëpërmjet përgatitjes së studentëve me njohuritë teorike shkencore por edhe aplikative në fushën e financës, kontabilitetit e bën më tërheqëse marrjen e njohurive në funksion të këtij vizioni. Në programin e studimit të detajuar, shohim se lëndët karakterizuese mbulojnë objektin e vete programit me fokus sektorin financiar publik dhe privat si dhe fushën e kontabilitetit që në trendin e zhvillimit të tij rrit kërkesën për përdorimin e njohurive në këtë fushë.</p> <p><i>Shtojca nr.1.Statuti i KUL</i>  <i>Shtojca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i></p>



	<p>Shtojca nr.15. Plani Strategjik i KUL 2018-2024</p> <p>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</p> <p>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit MP në "Financë Kontabilitet" është në përputhje me misionin dhe qëllimin e veprimtarisë të UGJ duke ruajtur interesat dhe vlerat kombëtare.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Bazuar në eksperiencën relativisht e gjatë të operimit të institucionit, (që nga viti 2008 dhe marrjen e akreditimeve institucionale në vitet 2017 dhe 2021), strukturën akademike, kapacitetet dhe burimet njerëzore të njësisë kryesore vlerësojmë se institucioni ofron garancinë për një programi MP në Financë Kontabilitet në përmbushjen e misionit dhe objektivave të tij. FE si njësi kryesore dhe DFK që mbulon këtë program studimi, arrijnë që nëpërmjet kualifikimit të nevojshëm dhe kapaciteteve akademike që ato kanë, të realizojnë me sukses zhvillimin e programit.</p> <p>Referuar tabelës 1.1 për stafin akademik të FE si njësi kryesore e programit të studimit rezultoi se kjo njësi përfshin tre Departamente:</p> <p>Departamentin e Finance kontabilitetit</p> <p>Departamentin e Menaxhimit</p> <p>Departamentin e Agrobiznesit.</p> <p>FE në vitin akademik 2022-2023 ka në përbërje 15 PAE dhe 21 PAK.</p> <p>DFKF si njësi bazë e programit të studimit të MP "Financë Kontabilitet" bazuar në tabelat anekse nr 1,1, 1.2 dhe 1.4 të RVB gjatë 3 viteve të fundit akademike ka pasur një numër të qëndrueshëm staf akademik por nën kufirin e plotësimin të kriterit ligjor të operimit të një njësie baze që përbëhet si me poshtë:</p>

	2019-2020 (13PA) 5 PAE 8 PAK	2020-2021 (11PA) 6 PAE 5 PAK	2021-2022 (13PA) 5 PAE 8 PAK
	<p>Bazuar në dokumentacionin e aplikimit dhe takimeve të zhvilluara në institucion ky mosplotësim kriteri është sanksionuar në marrëveshjen e MASR me KUL për reduktimin e numrit të personelit akademik efektiv. Në këtë marrëveshje referuar nenit 3 të saj përcaktohet se institucioni mund të mos plotësojë kushtin e numrit minimal të personelit akademik me kohe të plote për departamentin.</p> <p><i>Shtojca nr.1.Statuti i KUL, organigrama e KUL si aneks i Statutit Shtojca nr.28. Marrëveshjen e MASR me KUL për reduktimin e numrit të personelit akademik efektiv</i></p> <p><i>Shtojca: Aneks tabelat përmbledhëse Evidencë Tabela nr.1.1; 1.2; 2.1.dhe 2.3. në RVB</i></p>		
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Bazuar në rregullores së FE, rregulloren e DFK si dhe rregulloren e këtij programi studimi vihet re se ofrimi i këtij programi është në fushën e përgjithshme të ekonomisë që është fokus i njësisë kryesore (FE) dhe financë kontabilitetit që është fokus i njësisë baze (DFK).</p> <p>Bazuar në CV- e personelit akademik (PAE dhe PAK) që zhvillon këtë program konstatojmë se profili i tyre akademik dhe fusha e kërkimit shkencor përkohë kryesisht me fokusin e programit MP në Financë Kontabilitet.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e aplikimit të KUL si dhe nga takimi me personelin akademik të programit konstatuam angazhim të tyre në projekte kërkimore shkencore në fushën e financës.</p> <p>Programet e studimit në FE organizohen në dy nivele edhe në fushën e financës dhe kontabilitetit duke synuar të sigurojë njohuri të krahasueshme me institutet analoge universitare jashtë vendit.</p> <p><i>Shtojca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i></p> <p><i>Shtojca nr.15. Plani Strategjik i KUL 2018-2024</i></p> <p><i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i></p> <p><i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK</i></p> <p><i>Shtojca Aneks tabelat përmbledhëse . Tabela nr.1.1; 1.2; 2.1.dhe 3. në RVB</i></p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e</p>	<p>Bazuar në rregulloren e DFK, organizimit të tij shohim që kjo njësi mbulon programe studimi të ciklit të I-re dhe të II-te në</p>		

<p>programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>fushën e financës dhe kontabilitetit. Aktualisht DFK është përgjegjëse për 2 programe studimi, respektivisht, Bachelor, dhe MP në fushën e financë kontabilitetit. Edhe programi i studimit MP në “Financë Kontabilitet” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të kësaj njësie bazë, përgjegjëse për programin e studimit.</p> <p><i>Shtojca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i>  <i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i>  <i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK</i>  <i>Shtojca Aneks tabelat përmbledhëse . Tabela nr.1.1; 1.2; 2.1.dhe 3. në RVB</i>  <i>Shtojca nr.29. CV e stafit akademik të programit të studimit</i>  <i>Evidencë Aneks tabelat përmbledhëse . Tabela nr.1.1; 1.2; 2.1.dhe 3. në RVB</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit MP në “Financë Kontabilitet” është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore (FE) dhe baze (DFK) në KUL.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

### Standardi I.3

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda KUL dhe ndarja e detyrave dhe përgjegjësiwe mes njësisë kryesore, njësisë baze dhe gjithë strukturave mbështetëse të programit janë të sanksionuar në një sere aktesh rregullative dhe mbikëqyrëse, si statutin (Kreu II) rregullore e KLU, rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet dhe në udhëzime që përcaktojnë procedurat në funksion të këtij qëllimi. Një pamje të përmbledhur të strukturave përkatëse e jep edhe organi grama e KLU. Po ashtu janë një sere aktesh të tjera që dispijlojnë punën e dekanatit, departamentit, sekretarisë mësimore, zyrës se burimeve njerëzore apo hallkave të ndryshme të institucionit në të cilat përcaktohen rolet, funksionet dhe ndarja e përgjegjësiwe e tyre të cilat i shërbejnë mbarëvajtjes se programit të studimit.</p> <p>Struktura e institucionit përfshin të gjitha hallkat e nevojshme në funksion të procesit mësimor shkencor ashtu edhe të zbatimit dhe monitorimit të standardeve të cilësisë në procesin e mësimdhënies dhe mësim nxënies duke përfshirë edhe ato në funksion të ndryshimeve ligjore dhe nënligjore (NJSBC, Komisioni i Përhershëm i Garantimit të Sigurimit të Cilësisë)</p> <p><i>Shtojca nr.1.Statuti i KUL, organigrama e KUL si aneks i statutit</i>  <i>Shtojca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i>  <i>Shtojca nr.15. Plani Strategjik i KUL 2018-2024</i>  <i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i>  <i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK</i>  <i>Shtojca Aneks tabelat përmbledhëse . Tabela nr.1.1; 1.2; 2.1.dhe 3. në RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Në funksion të realizimit të objektivave mësimore dhe formuese të studenteve KUL ka nënshkruar një nume marrëveshje bashkëpunimi me institucione arsimore kërkimore jashtë vendit, marrëveshje bashkëpunimi me institucione arsimore shkencore brenda vendit dhe marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera që përfshijnë edhe aktore të biznesit.</p> <p>Një pjese e marrëveshjeve të bashkëpunimi janë realizuar kryesisht nëpërmjet projekteve të përbashkëta si Tempus, ERASMUS + etj. Këto marrëveshje përfshijnë shkëmbime reciproke të vizitave akademike shkencore si dhe marrëdhënie të tjera reciproke në fushën e kualifikimit, shkëmbimit të eksperiencave, realizimit të praktikave mësimore etj.</p>

	<p>Bazuar në pasqyrat anekse të RVB në nivel njësie kryesore shihet se kjo njësi aktualisht është pjese e një projekti ndërkombëtar. Gjithashtu ky bashkëpunim është materializuar përmes realizimit të 8 leksioneve të hapura me lektore të huaj si dhe 22 pjesëmarrjeve nga stafi i FE në aktivitete shkencore jashtë vendit.</p> <p><i>Shtojca nr.36. Marrëveshje bashkëpunimi mes KUL dhe IAL brenda dhe jashtë vendit</i></p> <p><i>Shtojca nr. 37. Marrëveshje bashkëpunimi mes KUL me biznesit</i></p> <p><i>Shtojca Aneks tabelat përmbledhëse . Tabela nr.19 të RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademikt dhe studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes së përcjellë dhe evidentimit gjatë vizitës në institucion, konstatohet se KUL ka marrëveshjes me institucione dhe sipërmarrje në funksion të realizimit të praktikës profesionale. Gjatë takimeve në FE, pedagogët u shprehën, por dhe studentët konfirmuan që pedagogët kontribuojnë në punësimin apo intershipet e tyre, përmes ndarjes së informacionit në auditor dhe mbështetjes në karrierën të tyre.</p> <p>Ne kuadër të këtij programi janë me interes marrëveshjet e KUL me institucione apo aktore të tilla të biznesit të fushës se finance kontabilitetit, të tilla si: banka tregtare, institucione të tjera financiare (mikrofinanciare) , Zyra të këmbimit valutor etj</p> <p><i>Shtojca nr.36. Marrëveshje bashkëpunimi mes KUL dhe IAL brenda dhe jashtë vendit</i></p> <p><i>Shtojca nr. 37. Marrëveshje bashkëpunimi mes KUL me biznesit</i></p> <p><i>Shtojca Aneks tabelat përmbledhëse . Tabela nr.19 të RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>DFK si njësia baze dhe përgjegjëse e këtij program evidenton nëpërmjet raporteve periodike të analizës vjetore përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit që ka institucioni me të tretet. në evidentuam në raportin periodik të prezantuar në aplikim ku trajtoheshin rezultatet e bashkëpunimit nëpërmjet të dhënave të shkëmbimeve të studenteve dhe stafeve në kuadër të marrëveshjeve me institucione homologe jashtë vendit, realizimin e intershipeve të studenteve pranë institucioneve dhe bizneseve vendase.</p> <p><i>Shtojca nr. 21. Raporti vjetor institucional për tre vitet akademike 2019/2020/2021/2022</i></p> <p><i>Shtojca nr. 22. Raporti vjetor i FE për tre vitet akademike, 2019/2020/2021/2022</i></p> <p><i>Shtojca nr. 23. Raporti vjetor i DFK për tre vitet akademike 2019/2020/2021/2022</i></p>




	<i>Vizita në institucion në takime me stafin akademik dhe studentet.</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit MP në "Finance Kontabilitet" bazohet në një numër marrëveshjesh bashkëpunimi mes KUL dhe institucioneve mësimore shkencore apo aktore të sipërmarrjeve të ndryshme duke mundësuar dhe marrjen e eksperiencës apo realizimin e praktikës profesionale të studenteve pranë tyre.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

### Standardi II.1

**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit MP në "Financë Kontabilitet" është bazuar në plotësimin e kërkesave ligjore dhe rregullative në fuqi si dhe në përputhje me VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, ku lëndët e modulet vlerësohen me sistemin e krediteve ECTS dhe orë, me një total 60 kredite me kohëzgjatje një vit akademik me 2 semestra dhe me ngarkesë studenti 25 orë në javë.  <i>Shtojca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i> <i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i> <i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë	Nga shqyrtimi i programit mësimor si dhe përmbajtjes së syllabuseve konstatohet se ai përfshin 8 lende (pa përfshirë praktiken profesionale ) dhe në të arrihet të transmetohen njohuri

profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.

në fushën e financës dhe kontabilitetit, si dhe aplikime praktike të njohurive në këtë fushe ( lendet, “ Kontabiliteti financiar i avancuar”, “Kontabiliteti i drejtimit” etj.) si dhe trajtime teoriko shkencore në lende financiare (lendet “Drejtimit financiar i avancuar”, “qeverisje e korporatave”) duke synuar të përmbush dhe objektivat e një programi Master Profesional. Kjo bën të mundur që studentët që përfundojnë këtë program mund të punësohen si specialistë të financës apo kontabilitetit pranë institucioneve financiare apo sipërmarrjeve private si dhe në sektorin publik.

*Bazuar në vlerësimin tone mendojmë që në kuadër të plotësimit më mirë të objektivave të tij , në këtë program ka nevoje të bëhen përmirësime të mundshëm të cilat do ti shërbenin me mire një programi të studimit MP në Financë dhe Kontabilitet të tilla si:*

- ❖ *Në këtë programin e studimit MP me periudhe 1 vjeçare dhe që ofron 60 kredite duhet të merren me shume njohuri në fushën e financës apo kontabilitetit dhe kjo mund të arrihet duke e rishikuar atë kryesisht në zëvendësimin e 2 lendeve që janë kryesisht teoriko shkencore të tilla si “Teoria dhe Drejtimi i Portofolit” , “Metodat e kërkimit”. Kjo do të rrisë me tej fleksibilitetin dhe mundësinë e marrjes se njohurive me të thelluara në fushën e financës dhe kontabilitet duke i zëvendësuar këto lende me lende karakterizuese.*
- ❖ *Të rritet numri i lendeve me zgjedhje. Kështu, mund të përfshihen që në semestrin e pare lende me zgjedhje si lënda “Kontabilitet Financiar i Avancuar” e cila është zëvendësuar në vitin 2022 me lenden “Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare te Kontabilitetit.*
- ❖ *Të gjitha lendet e programit janë vlerësuar me 6 kredite, gjë që nuk reflekton faktin që për lende të ndryshme angazhimi i studenteve jashtë auditorit është i ndryshëm.*

*Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.*

*Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK si dhe Aneket e RVB.tab.10*

**Kriteri 3.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e

Programi i studimeve Master i Profesional në “Financë Kontabilitet”, në përputhje me vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, ka

<p>praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>përcaktuar ngarkesën në kredite për praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse. Parashikohen 6 kredite për praktikën profesionale ose 150 orë gjithsej, nga të cilat 60 orë në auditor dhe 90 orë punë e pavarur nga studentët. Për detyrimet përmbyllëse parashikohen 6 kredite ose nga të cilat 60 orë në auditor dhe 90 orë punë e pavarur nga studentët. Mbrojtja e diplomës është detyrimi përfundimtar për diplomimin e studentit i cili vlerësohet me notë, njëlloj si detyrimet e tjera.</p> <p><i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i></p> <p><i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK si dhe Anekset e RVB.tab.10</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p><b>Nuk aplikohet në këtë program</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p><b>Nuk aplikohet në këtë program</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe</p>	<p>Bazuar në Statutin e KUL, dokumentacionin e aplikimit pranë ASAL-it si dhe nga vizita në institucion, GVJ vlerësojmë se forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi i</p>



<p>financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>veprimtarisë akademike kërkimore shkencore realizohet në përputhje me ligjin e arsimit të lartë të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë së arsimit.</p> <p><i>Shtojca nr.1.Statuti i KUL</i>  <i>Shtojca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i>  <i>Shtojca nr.15. Plani Strategjik i KUL 2018-2024</i>  <i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i>  <i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK Vizita në institucion e GVJ</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet</p>	<p>Bazuar në planin mësimor të programit vërejmë se ai ka përmbajtje të ngjashme në nivel rreth 70 për qind, me programe të tjera ofruar nga institucione të arsimit të lartë në Shqipëri dhe që kanë të njëjtën/pothuajse emërtesë.  FE dhe DFK aktualisht ofrojnë vetëm këtë program studimi MP</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Bazuar në RVB, KUL ka aplikuar në Ministrinë e Arsimit për caktimin e kodit përkatës sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve për programin e studimit Master Profesional në “Financë Kontabilitet” dhe është në pritje të vendimit nga ky institucion.  <i>Evidencë nr.1.22. Shkrese e UGJ; Propozimet për kodifikimin e programeve të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit programi Master Profesional në “Kontabilitet Financë” nuk është program i përbashkët midis IAL-ve, jashtë apo brenda vendit por realizohet vetë nga UGJ</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit MP në “Kontabilitet Financë” organizohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në strukturë dhe përmbajtje. Megjithatë në funksion të përmirësimit të tij sugjerimet e mësipërme të GVJ lidhur me këtë program studimi do e përmirësonim me tej atë në drejtim të konsolidimit aplikativ në fushën e kontabilitetit dhe financës .</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

### Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>FE si njësi kryesore përgjegjëse e programit MP në “Financë Kontabilitet” përmbush detyrimet ligjore lidhur me strukturën akademike dhe stafet akademike për zhvillimin e këtij program. Në vitin akademik 2021-2022 FE përfshin në strukturën 36 anëtarë si personel akademik nga të cilët 15 anëtarë janë PAE dhe 21 anëtarë janë PAK, që janë pjese e tre Departamenteve :</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës;</li> <li>2. Departamenti i Menaxhimit</li> <li>3. Departamenti i Agrobiznesit</li> </ol> <p>Njësia baze (DFK) si njësi baze dhe përgjegjëse e programit të studimit MP në Finance Kontabilitet gjate tre viteve të fundit ka pasur një numër të qëndrueshëm stafi por nën kufirin minimal të kërkuar (janë 5 anëtarë PAE), por që e kemi theksuar me lart ky numër është në përputhje me marrëveshjen që institucioni ka me Ministrinë e Arsimit. Për vitin 2021-2022 nga 5 PAE 2 prej tyre janë të kategorisë “Profesor” dhe 3 të tjerët mbajnë gradën shkencore “Doktor”, 1 është “Doktor “ne proces. Nga 8 anëtarët e PAK 3 janë të kategorisë Profesor, , 4 anëtarë mbajnë gradën shkencore Doktor) dhe 1 është Master i Shkencave.</p> <p><i>Shtojca nr.1.Statuti i KUL, organigrama e KUL si aneks i statutit</i>  <i>Shtojca nr.18.Organigrama e KUL</i>  <i>Shtojca: Aneks tabelat përmbledhëse Evidencë Tabela nr.1.1; 1.2; dhe 1.4. në RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik</p>	<p>Praktika profesionale e studentëve organizohet, ndiqet dhe mbikëqyret nga DFK përgjegjëse për programin e studimit. Departamenti cakton një pedagog i cili është përgjegjës për zhvillimin e seancave të zhvillimit profesional dhe karrierës në auditor.</p> <p>Gjithashtu FE ka 2 personel ndihmës akademik në realizimin e punëve laboratorike apo në ndihme të procesit mësimor që në</p>

/administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	strukturën e paraqitur përfshihen jashtë strukturës së departamenteve . <i>Shtojca: Aneks tabelat përmbledhëse Evidencë Tabela nr.1.1; 1.2; dhe 1.4. në RVB</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	GVJ bazuar në vizitën realizuar në KUL dhe dosjen e aplikimit , konfirmon se DFK si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në “Financë Kontabilitet ” ka caktuar si koordinator të programi Përgjegjës in e kësaj njësie një nga PAE të departamentit e cila është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në auditor si edhe për ndjekjen e praktikave në institucione apo njësi të tjera ekonomike. Detyrat dhe funksionet e koordinatorit janë të përcaktuara në rregulloren e DFK Shtojca nr.4. Rregullore e DFK <i>Shtojca nr.44.Vendimi nr.25 date 25.09.2021 i Dekanit të FE për caktimin e koordinatorëve të programeve</i> <i>Vizita në institucion dhe takimi me stafin akademik</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ, shpreh se njësia kryesore FE dhe ajo baze DFK përgjegjëse për programin e studimit përmbushin kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


### Standardi II.3

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit si dhe në vizitën e realizuar në institucion GVJ evidenton se FE si njësi kryesore dhe DFK si njësi baze e programit kane informacionin e plote mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij program. Stafit akademik në këto njësi njih rregulloren e këtij program, planin mësimor dhe përmbajtjen e programit të lendeve përkatëse që zhvillohen. Informacion rreth programit gjendet dhe në faqen e internetit të institucionit. <i>Shtojca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i> <i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i>

	<i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	GVJ evidentoi dhe shqyrtoj Shtojca të planeve mësimore, rregulloren e programit të studimit Master Profesional në “Financë Kontabilitet”, syllabuset e lëndëve ku përfshihet informacioni i plote për ndarjen e lëndëve në semestrale, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor si leksionet ashtu edhe seminarët, orët jashtë auditorit si puna e pavarur, si dhe të gjithë komponentët formues të programit, duke respektuar VKM nr.41.date 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit” e ndryshuar “. <i>Shtojca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i> <i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i> <i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit ofron të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Studentet nëpërmjet planit mësimor dhe kuadrit rregullator të brendshëm ( rregulloret e studimit në rang institucional, njësi kryesore/baze, dhe nivel programi kane informacionin e duhur që në procesin e pranimit , regjistrimit dhe zhvillimit të programit ashtu edhe procedurat e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. <i>Shtojca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i> <i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i> <i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK</i> <i>Shtojca nr. 70.Vendimi për kriteret e pranimit në programin e studimit MP në FK</i> <i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</i>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe	Duke shqyrtuar programet e lendeve (syllabuset) vërejmë se ato janë ndërtuar si strukture dhe në përmbajtje kryesisht në zbatim të VKM nr.41.date 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit” e ndryshuar, ku përfshihen: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Emërtimi i lëndës/modulet</li> <li>• Viti/semestri kur zhvillohet lënda dhe raporti i orëve në auditor</li> <li>• Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën</li> <li>• Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit</li> </ul>

<p>jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetimin e lëndës</li> <li>• Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë</li> <li>• Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik</li> <li>• Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS</li> <li>• Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre</li> <li>• Format e vlerësimit të studentëve</li> <li>• Detyrimet e studentit për lëndën</li> <li>• Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse</li> </ul> <p>Format e vlerësimit të mësimdhënies janë nëpërmjet vlerësimit periodik në seminare (për pjesëmarrje aktive), detyra kursi, provime të ndërmjetme dhe provim final. në të gjitha programet e lendeve vlerësimi i vazhduar zë një peshe specifike 30% deri 40% duke plotësuar këtë kriter.</p> <p><i>Nga shqyrtimi i përmbajtjes lëndore (syllabusve) vërejmë se në një numër të syllabusve literatura baze dhe sidomos ajo e rekomanduar i referohet viteve të hershme përpara vitit 2015 gjë që tregon mos reflektimin në program të botimeve të 5 viteve të fundit.</i></p> <p><i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i></p> <p><i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK</i></p> <p><i>Shtojca nr.26.Syllabuset e programit të studimit MP në FK</i></p> <p><i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e aplikimit të institucionit pranë ASCAL-it si dhe vizitën e GVJ në ambientet e KUL shohim që në vitin akademik 2022-2023 janë bere ndryshime në këtë program brenda 20 % të lejuar duke futur lenden e Menaxhim risku,” në vend të lendes “Menaxhim strategjik i Burimeve Njerëzore ,dhe Kontabilitet Drejtimi i Avancuar” në vend të lendes “Kontabilitet Financiar i Avancuar”. Ndryshime janë bere gjate këtyre viteve edhe në syllabuset e lendeve duke rifreskuar ato me informacion të kohës.</p> <p><b>Siç e kemi theksuar edhe me lart, është e nevojshme që programi mësimor të përmirësohet me tej me sugjerimet e dhëna më lart.</b></p> <p><i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i></p>





	<p><i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK</i>  <i>Shtojca nr.25.Procedura për ndryshimin e kurrikulës</i>  <i>Shtojca nr.26.Syllabuset e programit të studimit MP në FK</i>  <i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Programi i studimit MP në Financë Kontabilitet është i strukturuar dhe organizuar kryesisht në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi si dhe me objektivat formuese të këtij programi. Në këtë kontekst është e nevojshme përmirësimi në strukture por sidomos në referimin e literaturës me të fundit për disa nga lëndet e programit duke rritur cilësinë e programit lëndor. Përsa i përket këtij standardit II.3, GVJ shprehet se përmbushet kryesisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### **Standardi II.4**

**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit shohim që në përmbajtjen e tij ai ofron tiparet e një programi të nivelit të dytë në fushën e financës dhe kontabilitetit . Programi ndërtohet mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit dhe thellon njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përputhje me kriteret e vendosura. Këtë e shikojmë në përmbajtjen e lëndëve të programit ku është bere një gërshetim mes njohurive teoriko shkencore me ato aplikative dhe të kombinuara me realizimin e praktikës profesionale. Kjo jep mundësi punësimi në tregun e punës kryesisht të sektorit financiar e bankar. Në program dominojnë lëndet e fokusuar në objektin e tij që është kontabiliteti dhe financa.</p> <p><i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i>  <i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK</i>  <i>Shtojca nr.26.Syllabuset e programit të studimit MP në FK</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e</p>	<p>Programi arrin të pajisë studentët krahas njohurive të përgjithshme dhe specifike në fushën e financiare dhe kontabilitetit edhe mundësinë për të realizuar kërkime shkencorë në sektorë të veçante të cilat ballafaqohen me natyra të ndryshme të finance, kontabilitetit dhe riskut. Nga ana tjetër, programi arrin</p>



<p>objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>të rrisë edhe kompetencat profesionale të studentëve me fokus rritjen e aftësive aplikative që përfshijnë fushën e analizës dhe modelimit të riskut.</p> <p>Mbështetur në 8 lëndët që ofron programi, por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik shkencor dhe relativisht edhe atë aplikativ të studentëve. Në këtë kuadër praktika dhe përgatitja e mikrotezës që synohet të jetë aplikative, i shërbejnë këtij objektiv në rritjen më shumë të përgatitjes profesionale të studentëve.</p> <p><i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i></p> <p><i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK</i></p> <p><i>Shtojca nr.26.Syllabuset e programit të studimit MP në FK</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Programi në hartimin dhe zhvillimin e tij bazohet në eksperiencat bashkëkohore Europiane dhe të vendit, si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punës për specialiste në fushën e financës. Mbështetur në strukturën e programit, në lëndët që përfshihen në të, raportet teorike praktike, ky program përputhet me drejtimin e zgjedhur që është financa dhe kontabiliteti. Në të arrihet të trajtohen elementët e nevojshëm që lehtësojnë njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës jashtë vendit, për qëllim vazhdimin e studimeve apo punësimin e studentit. Programi i studimit është në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. në kuadër edhe të projektit të përbashkët në hartimin e këtij programi është bashkëpunuar edhe me universitetet analoge të disa prej vendeve të BE. Zhvillimi i këtij programi studimi është bazuar edhe në një studim tregu me operatorët kryesor të tij nëpërmjet intervistave dhe pyetësorëve të fokusuar në objektin e programit.</p> <p><i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i></p> <p><i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK</i></p> <p><i>Shtojca nr.26.Syllabuset e programit të studimit MP në FK</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik</p>	<p>Ky program studimi përmban të gjithë elementët e përcaktuar në Ligjin 80/2015 dhe VKM Nr.41, datë 24.01.2018. i ndryshuar. Veprimtaritë formuese kanë një shpërndarje si në tabelën më poshtë:</p>

mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	<b>Kategoria /</b>	<b>Përqindja Krediteve Sipas VKM</b>	<b>Programi MP në KF</b>	
			<b>Kredite</b>	<b>Përqindje</b>
	A. LËNDË BAZË	5%-10%	6	10%
	B. LËNDË KARAKTERIZUESE	30%- 40%	24	40%
	C. LËNDË NDËRDISIPLINORE	20%-30%	18	30%
	D. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika)	10%	6	10%
E. DETYRIME PËRMBYLLËSE	10%- 20%	6	10%	
	<p><b>Vlerësojmë se plani mësimor i ndare sipas veprimtarive formuese përmbushet në kategorizimin e lendeve ndërdisiplinore.</b></p> <p>Duke analizuar planin mësimor dhe programin mësimor të prezantuar në aplikimin e institucionit si dhe nga bashkëbisedimi me stafin që mbulon këtë program vërejmë se ka një raport të drejtë mes formimit teorik dhe atij praktik të studenteve. Nga shqyrtimi i programeve të lendeve shikojmë se në to kemi si trajtime teorike të avancuara ashtu edhe aplikime kryesisht në fushën e kontabilitetit. Trajtimi i rasteve studimore, punëve laboratorike dhe realizimit të praktikës mësimore harmonizon realizimin e objektivave të këtij program.</p> <p><i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i></p> <p><i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK</i></p> <p><i>Shtojca nr.26.Syllabuset e programit të studimit MP në FK</i></p> <p><i>Shtojca : Tabelat anekse të RVB, Tabela nr.9.</i></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke	<p>Siç e kemi evidentuar me lart GVJ konstatoi përditësim në programet e lendeve. Në vlerësim, mbeten rekomandimet e GVJ të dhëna me sipër me qëllim përmirësimin e tyre por edhe si reflektim i zhvillimeve të fundit në tregun financiar dhe kontabël.</p> <p><b>GVJ evidenton mangësitë në syllabuse të theksuara me lart (standardi 2.3. kriteri 4)</b></p>			



<p>përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p><i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i>  <i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK</i>  <i>Shtojca nr.26.Syllabuset e programit të studimit MP në FK</i>  <i>Shtojca : Tabelat anekse të RVB, Tabela nr.9.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Programi MP në “Financë Kontabilitet” i pajis studentët që zotërojnë tashmë një diplomë Bachelor në fushën e ekonomisë dhe financës, me njohuri më të thelluara teorike dhe praktike të fushës së menaxhimit të riskut. Gjithashtu, ky program u jep mundësi studentëve që mbarojnë studimet, të specializohen me njohuri të avancuara të përdorimit të teknikave të vlerësimit dhe menaxhimit të risqeve në sektorin financiar, kryesisht privat, si dhe në sektorët e tjerë të ndikuar nga risqet e natyrave të tjera. Kjo u jep më shumë mundësi në tregun e punës, sidomos në sektorin financiar dhe real të ekonomisë.</p> <p><i>Evidencë nr.2.9.Plani mësimor i programit Anekset e RVB.tab.10</i>  <i>Evidencë nr.1.9.Rregullore e programit MP në Financë Kontabilitet</i>  <i>Evidencë nr.2.26. Programet lëndore (Syllabuset e lendeve) të programit MP në Kontabilitet Financë</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit është mbështetur në eksperiencën e programeve të tilla kombëtare, por para se gjithash ato ndërkombëtare të universiteteve partnere të projekteve të përbashkëta. Gjithashtu, ky program u mundëson hyrjen në tregun e punës të studentëve jo vetëm në segmentin e sektorit financiar e bankar por edhe pranë institucioneve që mbulojnë sektorë reale të ekonomisë apo instituteve monitoruese të tregjeve të sektorëve të tjerë.</p> <p><i>Evidencë nr.2.9.Plani mësimor i programit Anekset e RVB.tab.10</i>  <i>Evidencë nr..19.Rregullore e programit MP në Kontabilitet Financë</i>  <i>Evidencë nr.2.26. Programet lëndore (Syllabuset e lendeve) të programit MP në Kontabilitet Financë</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Struktura dhe organizimi i programit janë në përputhje me objektivat formuese dhe kualifikimin sipas Kuadrit Kombëtar dhe European të Kualifikimit dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Përsa i përket këtij standardi II.4, GVJ shprehet se përmbushet plotësisht</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>FE si njësi kryesore dhe DFK si njësi bazë dhe përgjegjëse e këtij programi bazuar në marrëveshjet institucionale me aktorët e tregut të punës analizojnë periodikisht mundësitë e përmirësimit të programeve ku ajo është përgjegjëse drejtpërdrejt.</p> <p>Hapja e këtij programi nuk është paraprirë apo realizuar gjate 4 viteve të fundit ndonjë studim për tregun të punës për studente që diplomohen në MP në FK por me 60 kredite dhe periudhe kohore 1 vit akademik.</p> <p>Bazuar në tabelën nr.21 të anekseve të RVB shohim që në këtë program gjate tre viteve të fundit janë regjistruar totalisht 50 studente dhe përkatësisht sipas viteve: 18 studente, 19 studente dhe 20 studente. të diplomuar gjate 3 viteve të fundit (pa përfshirë vitin akademik 2023-2024) janë 43 që sipas viteve janë përkatësisht 15 studente, 9 studente dhe 19 studente. Nga ky numër 28 prej tyre apo rreth 66 % janë punësuar në përputhje me diplomën e studimit. Nga takimi me studentet e programit një numër prej tyre janë punësuar në financë apo kontabilitet.</p> <p><i>Tabelat anekse të RVB. Tabela nr.21, 23.</i></p> <p><i>Vizita e GVJ ne institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në vizitën pranë UGJ si dhe nga takimi me studentët e programit, Këshillit studentor dhe pjesëtarë të Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe kujdesit ndaj studentit, si edhe nga rregullorja e kësaj zyre rezulton se institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar. Po ashtu edhe DFK zhvillon diskutime me studente të këtij programi mbi përmirësimin të mundshme në program, por GVJ nuk e evidentoi këtë proces për arsytet e shprehura me lart.</p> <p><i>Shtojca 116.Pyetesor për vlerësimin e cilësisë se mësimdhënies</i></p> <p><i>Shtojca :Tabelat anekse të RVB. Tabela nr.21.23</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në institucion; Takim me studentet dhe Zyrën e Këshillimit të Karrierës.</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>DFK mban kontakte periodike me studentet e programit, Zyrën e Këshillimit dhe Karrierës në funksion të përmirësimit të programit dhe qasjes së tij me tregun e punës. GVJ nuk e evidentoi këtë proces për arsyet e shprehura më lart.  <i>Shtojca 116. Pyetësor për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies</i>  <i>Shtojca :Tabelat anekse të RVB. Tabela nr.21 dhe .23</i>  <i>Vizita e GVJ në institucion; Takim me studentet dhe Zyrën e Këshillimit të Karrierës.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ evidenton përkushtim të FE dhe DFK në përfshirjen e studenteve dhe aktoreve të tjerë në përmirësimin e programit të studimit me qëllim përmirësim të mundshëm të programit në funksion të nevojave të tregut financiar. Përsa i përket këtij standardi II.5, GVJ shprehet se përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.6</b>  <b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Financë Kontabilitet” është i ndërtuar në përputhje me vizionin, misionin, objektivat e institucionit si dhe në planin strategjik të KUL 2018-2024.  Ky program studimi sipas rregullores së programit dhe akteve të tjera rregullative të institucionit ka si mision t’i pajisë studentët me një sistem bazë njohurish që i formon ata në fushën e financës, kontabilitetit dhe auditimit.  <i>Shtojca nr.15. Plani Strategjik i KUL 201820-2024</i>  <i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike</p>	<p>FE dhe DKF bazuar në statutin e KUL bashkërendojnë procesin mësimor e shkencor të programeve të studimit përfshirë edhe këtë program. Gjatë vizitës në institucion në takimin me stafin e këtij programi u evidentua respektimi i lirisë akademike të përcaktuara në aktet nënligjore.  <i>Shtojca nr.15. Plani Strategjik i KUL 2018-2024</i>  <i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i></p>

të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	<i>Vizita e GVJ në institucion; Takim me drejtuesit e FE dhe , DFK dhe stafin akademik të programit.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	<p>Ky program studimi u jep mundësi studenteve të motivohen në përgatitjen e projekteve të kursit duke u dhënë atyre karakterin e një punimi teorike shkencore por edhe dhe aplikativ. Lendet si “Drejtimi financiar i avancuar” apo “ Menaxhim risku “ përbejnë një fokus i gjere për ndërmarrjen e punimeve shkencore dhe aplikative.</p> <p><b>Megjithatë GVJ nuk evidentoi përfshirje të studenteve të këtij programi në kërkime, projekte dhe aktivitete kërkimore në listën e projekteve ku është përfshire KUL.</b></p> <p>Megjithatë gjate takimeve ne institucion u evidentua qe studente te programeve te tjera kane marre pjese ne konferencën studentore qe ka organizuar KUL si dhe ne aktivitete kërkimore shkencore ne kuadër te projekteve me BE ku institucioni është partner.</p> <p><i>Shtojcë. Tabela përmbledhëse nr.22</i></p> <p><i>Shtojca nr.15. Plani Strategjik i KUL 2018-2024</i></p> <p><i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në institucion; Takim me drejtuesit e FE dhe , DFK dhe stafin akademik të programit</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	<p>Bazuar në statutin e UGJ, planin financiar për menaxhimin me efektivitet të institucionit si dhe pasqyrave financiare të institucionit, vihet re se, për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore ka mbështetje financiare në kuadër të një buxheti institucional nëpërmjet alokimit të fondeve në fushat e kërkimit shkencor.</p> <p><b>Gjate vizitës në institucion GVJ evidentoi financim në teknologji apo procesin mësimor (blerje tekstesh dhe literature shtese) por nuk evidentoi një politike te qarte financimi të drejtpërdrejtë nga buxheti në fushën e kërkimit shkencor për stafin e DFK por vetëm disa raste specifike. Anëtarë të stafit kane pasur financime kryesisht në kuadër të projekteve që ka fituar KUL.</b></p> <p><i>Vizita e GVJ në institucion; Takim me stafin akademik dhe pjesëtarë të zyrës se projekteve dhe partneriteteve .</i></p>
<b>Konkluzione</b>	<i>Përsa i përket këtij standardit II.6, GVJ shprehet se institucioni duhet të mbështesë në forme financimi të drejtpërdrejtë stafin</i>

	<i>akademik të DKF në fushën kërkimore shkencore duke mundësuar një angazhim me efikas të tyre.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi II.7</b>	
<b>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	<p>Bazuar në evidencat përkatëse të dhënave të kërkimit shkencor, të dhënat e bashkëpunimeve shkencore në rang fakulteti si dhe nga raportin analitik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për realizimin e programit të MP në “Financë Kontabilitet”, u evidentua se, FE si njësi përgjegjëse nxiti angazhimin e stafit akademik në projektet kërkimore-shkencore kryesisht nën kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit ose programit ERASMUS a si dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p> <p><i>Shtojca nr.36. Marrëveshje bashkëpunimi mes KUL dhe IAL brenda dhe jashtë vendit</i></p> <p><i>Shtojca nr. 37. Marrëveshje bashkëpunimi mes KUL me biznesit</i></p> <p><i>Shtojca Aneks tabelat përmbledhëse . Tabela nr.19 të RVB</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	<p>Bazuar në strategjinë e kërkimit shkencor të institucionit si dhe në rregulloren e institucionit dhe atë të vete programit të studimit MP në “Kontabilitet Financë”, theksojmë se njësia përgjegjëse (FE) dhe ajo baze (DFK), synojnë të angazhojnë stafin akademik dhe studentët në projekte dhe kërkime shkencore.</p> <p>GVJ evidenton një pjesëmarrje të kënaqshme të stafit akademik në pjesëmarrje të tyre në aktivitete shkencore jashtë IAL (janë 22 te tilla) <b>Megjithatë, fakti që në nivel njësie kryesore dhe bazë numri i projekteve kërkimore shkencore të fituara dhe të zbatuara është vetëm 1 i tillë tregon se këto njësi duhet të jene me aktive në këtë proces.</b></p> <p><i>Shtojca nr.36. Marrëveshje bashkëpunimi mes KUL dhe IAL brenda dhe jashtë vendit</i></p> <p><i>Shtojca nr. 37. Marrëveshje bashkëpunimi mes KUL me biznesit</i></p> <p><i>Shtojca Aneks tabelat përmbledhëse . Tabela nr.19 të RVB</i></p>




<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Bazuar në tabelat anekse të RVB (tabela nr.19 ) shikojmë se FE si njësi përgjegjëse e programit nuk ka organizuar konferenca apo aktivitete shkencore. Ky angazhim është realizuar në kuadër të botimeve të stafit akademik në formën e referimeve në konferenca shkencore, pjesëmarrjes në projekte të tillë apo botimin e librave universitare.</p> <p>Një drejtim tjetër është realizimi i angazhimit të lektorëve të huaj në prezantimin e temave në fushën e programit ku evidentohet që për këtë program kemi pasur angazhimin e 1 lektori të huaj.</p> <p><b>Megjithatë, GVJ mendon se FE dhe DFK duhet të jene me aktiv dhe të planifikojnë dhe intensifikojnë punën në rritjen e angazhimit të personelit akademik te programit te studimit në fushën kërkimore shkencore, gjë që do të sillte edhe rritjen e kualifikimit akademik të tyre ( për vitin akademik 2021-2022 nga 10 anëtarë staf akademik te programit 2 anëtarë PAE janë Doktor ne proces).</b></p> <p><i>Tabelat anekse të RVB. Tabela nr.2, 4.3, 19 dhe 20</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Referuar programit të studimit, përmbajtjes lëndore mendojmë se studentet e diplomuar janë të afte të konkurrojnë në tregun kombëtar dhe sidomos atë lokal të punës..</p> <p><i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Programi i studimit përputhet me ligjet dhe aktet nënligjore vendase dhe ndërkombëtare që rregullojnë profesionet përfshirë dhe direktivat dhe rregulloret e BE..</p> <p>Ky program studimi garanton njohuri te kënaqshme ne fushën e kontabilitetit dhe përbush kriterin kryesor që studentet e diplomuar të mund të marrin licencën e “Kontabilistit të miratuar” nga Instituti i Eksperteve Kontabël të Miratuar ( IEKA) sipas procedurave ligjore dhe nënligjore për marrjen e kësaj licence. Përmbajtja e lendeve të fushës se kontabilitetit që zhvillohen në këtë program është baze edhe pre provimin e kontabilitetit që zhvillohet për marrjen e kësaj licence. Nga ana tjetër programi është me 60 kredite është i limituar në numër lendesh të fushës se kontabilitetit dhe financës. Është kjo arsyeja që GVJ mendon që duhet te vijojë azhornimi i literaturës dhe i lendeve me zgjedhje te sugjeruara me lart.</p> <p><i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK si dhe tabela nr.10 e Aneks Raportit</i></p>

<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i> ).				
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se program i studimit garanton njohuri të thelluara në kontabilitet dhe financë si dhe mundësi punësimi të suksesshëm, por që duhet të paraprihen nga një planifikim dhe angazhim me serioz i njësisë kryesore dhe asaj baze përgjegjëse të programit për rritjen e kualifikimit akademik dhe shkencor..</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT


<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e	Mësimdhënia në programin MP në “Financë Kontabilitet” bazohet në rregulloren mësimore në nivel institucional, si dhe në rregulloren e këtij programi në të cilat përcakton format e mësimdhënies dhe vlerësimin e dijeve të studentëve. Procesi mësimor zhvillohet nëpërmjet formave të mirënjohura: leksione, seminare, detyra kursi, ushtrime, etj, të organizuara në 8 lëndë, ku

<p>klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>janë parashikuar provime me shkrim, praktika dhe tema e diplomës. Lëndët klasifikohen vetëm si lëndë të detyruara.</p> <p>Në këtë program lëndët zhvillohen sipas syllabusit përkatës dhe në liri të plotë të personelit akademik. Për të ruajtur objektivitetin e vlerësimit forma e kontrollit në program është me shkrim dhe e sekretuar. Në politikën e Institucionit është praktikë që nota e studentit të jetë e “ndërtuar”, kjo do të thotë që studentit testohet gjatë semestrit në secilën lëndë përveç provimit përfundimtar në sezon. Shumatorja e pikëve të mbledhura përbën vlerësimin e tij përfundimtar. Forma e vlerësimit referuar ECTS përcaktohen me notë (1 deri 10) dhe ekuivalentin e notave me shkronja nga F në A. Ky sistem vlerësimi përfshin 100 pikë, të cilat janë të ndara në vlerësime gjate zhvillimit lendes dhe në provimin përfundimtar.</p> <p>Mënyra e vlerësimit të studentëve është e prezantuar në syllabusin e çdo lënde.</p> <p><i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i></p> <p><i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK</i></p> <p><i>Shtojca nr.26.Syllabuset e programit të studimit MP në FK</i></p> <p><i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik që mbulon këtë program ka aftësi të pedagogjike bashkëkohore në mësimdhënie rrjedhojë kjo edhe e eksperiencës relativisht të gjatë në procesin e mësimdhënies. Nga ana tjetër, nga takimi me studentët e këtij programi, GVJ evidentoi faktin e marrjes parasysh në dy raste të kërkesave të studentëve lidhur me përmirësimin e procesit të mësimdhënies për të kryer më shumë seanca aplikative të modeleve ekonometrike duke rritur nivelin kërkues e shkencor të mësim nxënies nga studentët. Në mbështetje të një performace me të mire mësimdhënieje stafit të programit i kanë shërbyer edhe mobilitetet e realizuara në kuadër të disa programeve ERASMUS + të viteve të fundit.</p> <p><i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i></p> <p><i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK</i></p> <p><i>Shtojca nr.26.Syllabuset e programit të studimit MP në FK</i></p> <p><i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</i></p>



<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Bazuar në takimin me stafin e DFK rezulton se institucioni mbështet stafin akademik në përmirësimin e metodës pedagogjike kryesisht nëpërmjet vizitave pranë universiteteve homologe të huaja, si dhe mobiliteteve në kuadër të projektit ERASMUS +.</p> <p>Se fundmi miratimi i udhëzuesit mbi metodat inovative të mësimdhënies dhe me e rëndësishmja aplikimi i këtij udhëzuesi në procesin mësimor është një mundësi e rritjes se cilësisë mësimdhënëse të personelit akademik.</p> <p>Personeli akademik ka mundësi të përfitojë nga programet e shkëmbimit të stafit me universitetet partnere perëndimore, për të shkëmbyer eksperiencë dhe njohur me praktikat e mira ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijes. Në kuadër edhe të zhvillimeve të viteve të fundit stafi akademik ka përdorur edhe platformat e njohura të mësimdhënies online si e-learning Microsoft Teams apo Google Classroom të cilat ishin dhe metoda kryesore gjate periudhës së pandemisë COVID 19..</p> <p><i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i></p> <p><i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK</i></p> <p><i>Shtojca nr.26.Syllabuset e programit të studimit MP në FK</i></p> <p><i>Shtojca nr.33.Mobilitete të stafit akademik</i></p> <p><i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit të student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik që mbulon këtë program ka ekspertizën e duhur për një proces mësimdhënie të suksesshëm. Bazuar në CV-të e stafit akademik që mbulon këtë program, vëmë re që pothuajse të gjithë kanë një formim akademik dhe profesional në fushën e financës, kontabilitetit si dhe të lendeve të fushave të veprimtarive formuese të tjera .</p> <p>Gjithashtu, metodat e mësimdhënies të përdorura nga stafi akademik, përshkruhen në syllabusin e secilës prej lëndëve/moduleve të programit të studimit. Seksioni “Metoda pedagogjike e përdorur në seminarin e radhës”, është një element i rëndësishëm në formatin e miratuar për syllabuset e lëndëve të programit të studimit, duke përshkruar materialet për diskutim dhe rastet studimore për secilën prej temave.</p> <p>Në vitin akademik 2021-20223 PAE zhvillon 75 % të ngarkesë në auditor të programit ndaj 25 % që mbulon PAK, duke plotësuar kriterin përkatës.</p>

	<p><i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i></p> <p><i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK</i></p> <p><i>Shtojca nr.26.Syllabuset e programit të studimit MP në FK</i></p> <p><i>Shtojca nr.29. CV e stafit akademik</i></p> <p><i>Shtojca nr.33.Mobilitete të stafit akademik</i></p> <p><i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik dhe studentet u evidentua që format tashme të njohura të mësimdhënies nëpërmjet leksioneve , seminareve kane prirje të behën interaktive dhe në forme diskutimi duke përdorur edhe kanalet bashkëkohore të transmetimit të njohurive në funksion të mësimdhënies dhe mesimnxenies.</p> <p>Në kuadër të këtij procesi NJSBC e riorganizuar realizon me studentet tërheqjen e mendimit të tyre edhe nëpërmjet pyetësorëve formave të mësimdhënies , vlerësimin e pedagogeve si dhe vlerësimin e lendes. Kjo forme vlerësimi ka qene periodike ka evidentuar dhe vlerësuar situatën e mësimdhënies në institucion.. Problematikat e dala nga anketimi i studentëve diskutohen në njësinë kryesore (FE) dhe atë baze (DFK ) me synim rritjen e cilësisë së mësimdhënies. <i>Nga shqyrtimi i raporteve të NJSB mbi organizimin e pyetësorëve vërehet një pjesëmarrje relativisht e ulët e studenteve në këtë proces (për këtë program studimi)</i></p> <p>Në takimin me studentët e programit ata prezantuan edhe sugjerimin që kishin bërë në takimet me pedagogun e lendes kryesisht për rritjen e trajtimeve me karakter praktik dhe aplikativ të cilat ishin marrë në konsideratë nga pedagogët përkatës të lëndëve.</p> <p><i>Shtojca nr.116. Pyetësor për vlerësimin e cilësisë se mësimdhënies . Pyetësor studentor.</i></p> <p><i>Shtojca nr.96 Aktivitete e FE të KUL për tre vitet e fundit akademike</i></p> <p><i>Shtojce 111. Raport vjetor i NJSBC viti 2020-2021 dhe 2021-2022</i></p> <p><i>Shtojca nr.6.Rregullore për sigurimin e cilësisë</i></p> <p><i>Takimi me studentet gjate vizitës në institucion.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimit evidentojmë se është realizuar ristrukturimi që në muajin mars 2022 nëpërmjet miratimit dhe operimit të strukturave të sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucioni që është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), Komisioni i përhershëm i</p>





<p>mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>garantimit dhe sigurimit të cilësisë. Këto dy struktura ndjekin dhe vlerësojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësim nxënies të programeve të studimit. Institucioni nuk ka njësi të sigurimit të cilësisë në nivel të njësisë kryesore. NJSBC koordinon punën me njësinë bazë që është DFK si njësi përgjegjëse e këtij programi. NJSBC monitoron procesin e vlerësimit të mësimdhënies, hulumton modele të ndryshme, vlerëson veprimtaritë e lidhura me vlerësimin e shërbimeve akademike dhe administrative, etj</p> <p><b><i>Mendojmë se realizimi i anketimit të studenteve duhet të realizohet me një pjesëmarrje me të madhe të të gjithë studenteve të MP në FK bazuar edhe në faktin se numri i studenteve është relativisht i ulët. Kjo do të rriste me shume nivelin dhe rëndësinë e kësaj forme vlerësimi.</i></b></p> <p><i>Shtojca nr.116. Pyetësor për vlerësimin e cilësisë se mësimdhënies . Pyetësor studentor.</i></p> <p><i>Shtojca nr.96 Aktivitete e FE të KUL për tre vitet e fundit akademike</i></p> <p><i>Shtojce 111. Raport vjetor i NJSBC viti 2020-2021 dhe 2021-2022</i></p> <p><i>Shtojca nr.6.Rregullore për sigurimin e cilësisë</i></p> <p><i>Takimi me studentet gjate vizitës në institucion.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson se institucioni garanton realizimin e aftësimit profesional e shkencor me metodat bashkëkohore të mësimdhënies me qendër studentin. Gjate vitit 2022 ka plotësuar kuadrin rregullativ dhe strukturat përkatëse në funksion të cilësisë se mësimdhënies. Megjithatë këto struktura tashme duhet të intensivikojnë pune e tyre si në drejtim të rritjes se cilësisë nëpërmjet metodave interaktive të mësimdhënies ashtu edhe të realizimit sa me efektiv të vlerësimit nga ana e studenteve të procesit mësimor si dhe të vete stafit akademik.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi III.2**

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të</p>	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloret e posaçme, të</p>





<p>njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>cilat janë pjesë zbatuese si në nivelin institucional (Rregullore e KUL, rregulloren e këtij programi si dhe në manualin e zhvillimit të provimit. Këto dokumente janë të publikuara dhe studentët kanë akses në to. Më të specifikuara mënyrat e testimit jepen në syllabuset e lëndëve përkatëse.</p> <p><i>Shtojca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i>  <i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar në syllabusin e pedagogëve të studimit programin e studimit MP në “Financë Kontabilitet” dhe vizitës në institucion u konstatua se pedagogu i secilës lëndë, javën a parë të mësimit bën prezantimin e përmbajtjes së lëndës, objektivat, temat e lëndës si dhe elementët e tjerë të syllabusit.</p> <p><i>Evidencë nr.2.26. Programet lëndore (Syllabuset) e programit të studimit</i>  <i>Takimi me stafin akademik gjate vizitës në institucion</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet në format tashmë të konsoliduar dhe përfshijnë elementë të vlerësimit të vazhdueshëm në seminar, testimin e ndërmjetëm, detyrat e kursit, provimin përfundimtar etj, elementë këto që u evidentuan të përcaktuara në syllabuse në kriteret standarde.</p> <p><i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i>  <i>Shtojca nr.26. Syllabuset e programit të studimit MP në FK</i>  <i>Takim gjate vizitës në institucion</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se ky i fundit ka të plotë kuadrin rregullator, mbikëqyrës dhe procedural të vlerësimit të dije të studentëve gjatë procesit mësimor.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi III.3**


**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve bazohet në praktikat më të mira të përdorura në IAL. GVJ, gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, evidentoi praktika vlerësimi të semestrit të parë të të këtij programi, në disa nga lëndët për të cilat ishte përmbyllur vlerësimi. Njohuritë e marra gjatë zhvillimit të këtyre lëndëve në semestrin përkatës vlerësohen deri në 30 -40 % të notës përfundimtare (angazhim në seminar dhe detyra/projektet e kursit si dhe testi i ndërmjetëm), ndërsa provimi përfundimtar zë 60 % të vlerësimit, duke reflektuar kështu edhe përcaktimin e këtij vlerësimi sipas syllabusit. Procesi i realizimit të vlerësimit është trajtuar edhe në rregulloren e programi dhe përfshin edhe aspekte të tjera të tij si sekretimin, kohën e shpalljes se rezultateve , ankimimin e studentet etj.</p> <p>Dy vitet e fundit Fe ka aplikuar për studentet e programit MP në FK platformën Edupage si një mjet transparent komunikimi dhe informacioni mes pedagogut dhe studentit</p> <p>GVJ evidentoi dhe zhvillimin online të procesit mësimor gjate periudhës se pandemisë e paraprirë me rregulloren përkatëse dhe platformat e përdorura në këtë proces.</p> <p><i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i></p> <p><i>Shtojca nr.26.Syllabuset e programit të studimit MP në FK</i></p> <p><i>Shtojca nr. 63.Manuali i përdorimit të platformës Edupage</i></p> <p><i>Takim gjate vizitës në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Pothuajse të gjitha vlerësimet e lendeve të programit realizohen me shkrim në baze të modelit të aprovuar të tezes se provimit. Dy vitet e fundit UGJ ka filluar të aplikojë sistemin e vlerësimit elektronik dhe ka aplikuar disa vlerësime lendesh me sistemin elektronik të testimit (<i>Projekti clean score</i>).</p> <p>Institucioni në të tre nivelet e tij ka rregulloret përkatëse lidhur me format e zhvillimit të provimit ashtu edhe udhëzime për këtë proces.</p> <p><i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i></p>
	<p><i>Shtojca nr.9. Rregullore e Sekretarisë mësimore</i></p> <p><i>Shtojca nr.26.Syllabuset e programit të studimit MP në FK</i></p> <p><i>Takim gjate vizitës në institucion</i></p>




<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Për realizimin e vlerësimin përfundimtar të dijeve të studentëve DFK, bazuar në rregulloret përkatëse në nivel institucional dhe të vete këtij programi , në bashkëpunim me sekretarinë mësimore, miratojnë komisionet e provimit me një numër anëtarësh stafi jo më pak se 2, ku njëri është titullari i lëndës dhe tjetri është pedagog i fushës përkatëse. GVJ evidentoi nënshkrimin e anëtarëve të komisionit në procesverbalet e provimeve të lëndëve, si dhe praktikave profesionale të firmosura nga 2 anëtarët e komisionit të provimit dhe Përgjegjësi i DKF.</p> <p><i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i></p> <p><i>Shtojca nr.9. Rregullore e Sekretarisë mësimore</i></p> <p><i>Vizite e GVJ dhe takim me sekretarinë mësimore dhe stafin akademik</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Zhvillimi i testimit të vlerësimit bazohet në anonimitetin dhe monitorim nga DFK. Kushtet e zhvillimit të provimit janë optimale dhe hapësirat ndërmjet studentëve në këtë proces janë të përshtatshme. Në raste zhvillimit të testimit në laborator shtohet dhe personel mbikëqyrës gjatë zhvillimit të provimit. Format i tezes se provimit ka si seksion me vete komentet e pedagogut për përgjigjet e studentit për pyetjet që kërkojnë qëndrim/opinion të studentit. Në fund të tezes është vlerësimi i detajuar sipas pyetjeve teorike dhe ushtrimeve.</p> <p><i>Shtojce nr.3.Rregullorja e FE</i></p> <p><i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet</i></p> <p><i>Vizita në institucion e GVJ ( pranë sekretarisë mësimore)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Bazuar në kuadrin e brendshëm rregullator si dhe nga takimi me stafin akademik dhe studentet e programit evidentohet korrektësia e zhvillimi të provimit si me monitorimin nga dy pedagoge anëtarë të komisionit ashtu edhe moslejimi i përdorimit të celularëve apo formave të tjera të kopjimit. Mos lejimi i plagjiaturës apo kopjimi gjatë provimit janë të sanksionuar në rregulloren e KUL (neni 119 dhe 120 )</p> <p><i>Shtojca nr.2.Rregullorja e përgjithshme e KUL</i></p> <p><i>Shtojce nr.3.Rregullorja e FE</i></p> <p><i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet</i></p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin përkatës por edhe gjate takimeve me stafin akademik dhe studentet evidentohet se vlerësimi i dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën, ku pedagogu krahas realizimit të sekretimit të tezave shpall rezultatet e vlerësimit brenda kohës se parashikuar sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. Dorëzimi i vlerësimevetë provimeve bëhet brenda 5 ditëve nga data e zhvillimit të tyre brenda të cilave përfshihen edhe seancat sqaruese (nga takimi me stafin akademik). Vlerësimi për komponentët e tjerë duhet të dorëzohen përpara zhvillimit të provimit përfundimtar, dhe pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshim pas zbardhjes së rezultateve të provimeve.</p> <p><i>Shtojca nr.2.Rregullorja e përgjithshme e KUL</i>  <i>Shtojce nr.3.Rregullorja e FE</i>  <i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet</i>  <i>Vizita në institucion e GVJ ( me stafin akademik dhe pranë sekretarisë mësimore)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Bazuar në rregulloret përkatëse të studimit student ka 3 dite kohe pas shpalljes se rezultatit të vlerësimit që të beje ankese nëse ai ka pretendime për një vlerësim me të larte. Institucioni ka model formulari tip për ankimimin e student. Atij i jepet mundësia të ballafaqohet me pedagogun e lendes dhe vlerësimin e bere si dhe i jepet përgjigja edhe e shkruar në formular. Nga takimi me studentet e këtij program gjate vizitës në institucion ata nuk kishin pasur praktike të tille. Reklamimi për vlerësimin nuk kishte shkruar në këtë faze pasi ishte zgjidhur gjate takimit që pedagogu i lendes zhvillon me studentet në datën e paracaktuar para se të hedhe vlerësimet përfundimisht në sistem.</p> <p><i>Shtojca nr.2.Rregullorja e përgjithshme e KUL</i>  <i>Shtojce nr.3.Rregullorja e FE</i>  <i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet</i>  <i>Vizita në institucion e GVJ ( me stafin akademik dhe pranë sekretarisë mësimore)</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e</p>	<p>Në rast të kërkesës për ankimim që bën student sipas formularit të miratuar pasi është ezauruar takimi me pedagogun e lendes Dekani në bashkëpunim me përgjegjësin e DFK ngre një komision ad-hok për rivlerësim të provimit. Në përfundim të vlerësimit Komisioni jep vendimin final duke e bere transparente</p>

përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	procesin me studentin dhe pedagogun e lendes përkatëse. Për këtë program në nuk evidentuam një realizim praktike të tilla. <i>Vizita në institucion e GVJ; takimi me studentet e programit</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se arrihet një vlerësim i drejtë i dijeve të studenteve duke respektuar konfidencialitetin, paanësinë dhe të drejtën e ankimit nga studentet dhe zgjidhjes së saj.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Bazuar në planin mësimor, programi i studimit MP në “Financë Kontabilitet”, bazohet mbi njohuritë e marra në ciklin e parë të studimit në Financë dhe garanton thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësitë profesionale dhe shkencore të studentëve në fushën e financës, kontabilitetit dhe auditimit. Mbështetur në module që ofron programi, por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të që në semestrin e parë, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik, profesional dhe relativisht edhe atë shkencor të studentëve. <i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i> <i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK</i> <i>Shtojca nr.26.Syllabuset e programit të studimit MP në FK</i> <i>Takimi me stafin akademik dhe studentët e programit</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Bazuar në programin e studimit MP në “Financë Kontabilitet”, si dhe syllabuseve të lëndëve shikohet se zhvillohen aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit dhe ndërveprimit. Njëkohësisht gjejnë relativisht trajtime në zhvillimin e aftësive në fushën e informacionit në trajtimin e rasteve studimore në një numër lëndësh të këtij programi. Lende të tilla si “ Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Kontabilitetit ” , “Kontabilitet Drejtimi i Avancuar “në të cilat përdoren dhe programet aplikative kompjuterike rrisin me tej aftësinë e përdorimet të teknologjisë se




	<p>informacionit, komunikimin dhe ndërveprimin si aspekte të rëndësishme të fitimit të dijeve në këto fusha.</p> <p><i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i></p> <p><i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK</i></p> <p><i>Shtojca nr.26.Syllabuset e programit të studimit MP në FK</i></p> <p><i>Takimi me stafin akademik</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lëndë, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Nga takimi me stafin e programit dhe studentët, GVJ evidentoi që në orën e fundit të leksionit/seminarit bashkëbisedohej mes pedagogut dhe studentit realizimi i programit të lëndës (bazuar në syllabusin e paraqitur që në fillim të semestrit). Përfitimet e marrjes se njohurive shihen të lidhura ngushte edhe me mundësinë e aplikimit të tyre në pozicione të ndryshme të punës në sektorin e financës.</p> <p><i>Vizita në institucion dhe takimi me stafin e programit dhe studentet</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacion dhe takimin e zhvilluar me stafin e programit, konstatohet që anëtarë të tij realizonin zhvillimin e programit në tema të caktuara nëpërmjet punëve laboratorike. Më e theksuar kjo realizohet në lëndët e karakterizuese të kontabilitetit dhe financës, lëndë këto që në aplikimin e tyre kërkojnë edhe një angazhim shtesë jashtë kornizës së syllabusit duke u zhvilluar në laborator.</p> <p>Eksperiencia e stafit akademik si dhe mobilitetet e realizuara prej tyre në kuadër të programit ERASMUS+, apo pjesëmarrës në projektet kërkimore mundësojnë rritjen e nivelit të mësimdhënies.</p> <p><i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i></p> <p><i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK</i></p> <p><i>Shtojca nr.26.Syllabuset e programit të studimit MP në FK</i></p> <p><i>Takimi me stafin akademik</i></p>






<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>KUL realizon zhvillimin e leksioneve të hapura me personalitete të fushave të ndryshme, të cilat realizohen kryesisht në rang institucional. Megjithëse janë në numër të ulët edhe FE dhe DFK organizojnë leksione të hapura me studentet e këtij program duke ftuar personalitete apo specialiste të mirënjohur në këtë fushë me trajtimin e temave të financës apo riskut në ekonomi. në takimin me studentet e programit ata konfirmuan pjesëmarrje në dy leksione të hapura që janë zhvilluar në FE.</p> <p><i>Shtojca nr.96. Aktivitete e FE të KUL gjate tre viteve të fundit Vizita në institucion dhe takime me stafin akademik dhe studentet</i></p>		
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Nga takimi me studentët e programit GVJ evidentoi që mbështetja e studentëve konsiston në krijimin e klimës favorizuese dhe të përshtatshme për të realizuar detyrat e kursit. Kjo arrihet nëpërmjet kontakteve apo njohjeve që pedagogu i lëndës ka me drejtues institucionesh duke mundësuar angazhimin e tyre me studentët sidomos gjate realizimit të praktikës.</p> <p>Gjate tre viteve të fundit FE ka organizuar 2 konferenca studentore duke bere të mundur bashkëpunimin edhe mes studenteve të FE të KUL me studente të universiteteve të tjera në programet ekonomike.</p> <p><i>Vizita në institucion dhe takime me stafin akademik dhe studentet</i></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ evidenton se programi i studimit garanton dhënien e njohurive teorike shkencore dhe kryesisht ato aplikative me tipare të një programi mësimor të nivelit të dyte MP në FK. Përsa i përket standardit III.4, GVJ shprehet se përmbushet plotësisht</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>


<p><b>Standardi III.5</b>  <b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Studentët e këtij programi, pas përmbylljes së gjithë detyrimeve, kanë të drejtën e mbrojtjes së diplomës kryesisht përmes provimit përfundimtar apo nëpërmjet një punimi Mikroteze. Kriter për mënyrën e vlerësimit të përmbylljes se programit të studimit është nota mesatare e studentit. Procedura e mbrojtjes përfundimtare, kriteret e mbrojtjes me provim final apo punim diplome janë të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit ( neni 14 ) dhe rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë. Ky proces është me i</p>



	<p>detajuar në udhëzuesin e mbrojtjes së diplomës si një dokument me vehte. Të gjitha procedurat e posaçme lidhur me mbrojtjen e diplomës hartohen nga institucioni dhe bëhen publike për të gjithë studentët.</p> <p><i>Shtojca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i>  <i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i>  <i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK Vizita në institucion e GVJ</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>DFK, si njësi bazë e programit, së bashku me strukturat ndihmëse, informojnë, ndjekin dhe monitorojnë procesin përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës me provim final apo punim e Mikroteze. Për studentet që do përmbyllin studimet me provim final hartohet programi i provimit të formimit me njohuri formuese nga gjithë lëndet, por kryesisht ato në kontabilitet dhe finance. Për studentet që do përmbyllin studimet me punim mikroteze ,pas marrjes së informacionit ata plotësojnë formularin e aplikimit ku përcaktojnë fushën e studimit, strukturën paraprake të tij dhe propozimin për udhëheqësin e punimit. Në DFK përcaktohen udhëheqësit për çdo student, të cilët kanë përgjegjësi për mbarëvajtjen e këtij procesi, cilësinë dhe përfundimin në afat. Ky proces u evidentua edhe gjatë vizitës në institucion. në ndihme të studenteve për këtë qellim organizohet seanca metodologjike në auditor ku jepen udhëzimet përkatëse për përgatitjen e punimit përmbyllës.</p> <p><i>Shtojca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i>  <i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i>  <i>Shtojca nr.14. Udhëzim për Përgatitjen dhe mbrojtjen e temës së diplomës . Vizita në institucion e GVJ; takimi me stafin akademik dhe studentet e programit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Lidhur me diplomimin e studentëve, me propozim të përgjegjësit të Departamentit dhe miratimit nga Dekani, ngrihet Komisioni i Provimit të Formimit i cili në vlerësimin e punimit të Mikrotezës bazohet në disa kriterë kryesore si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ecurinë dhe nivelin e vlerësimit të marrë në mësimet gjatë vitit akademik;</li> <li>• Përdorimi i metodologjisë shkencore të punimit;</li> <li>• Originaliteti i punimit</li> <li>• Dobia e punimit</li> <li>• Cilësia e të shkruajturit</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Paraqitja teknike</li> <li>• Cilësia e prezantimit</li> <li>• Vlerësimin që jep pedagogu udhëheqës i punimit të studentit në formularin përkatës;</li> </ul> <p>GVJ konstatoi se kjo praktikë rezulton e plotësuar nga evidentimi me studentë të programeve të tjera që kanë përfunduar programi, pasi studentët e këtij programi ende nuk e kanë përmbyllur programin.</p> <p>Për studentet që përfundojnë programin e studimit nëpërmjet provimit final vlerësimi nga Komisioni i provimit bazohet në përgjigjet e tyre të pyetjeve të tezes përkatëse si dhe pyetjeve të tjera nga Komisioni.</p> <p><i>Shtojca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i>  <i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i>  <i>Shtojca nr.14. Udhëzim për Përgatitjen dhe mbrojtjen e temës së diplomës</i></p>
<p><b>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</b></p>	<p>Në funksion të fushës së punimit të propozuar nga studenti, DFK miraton listën e pedagogëve udhëheqës për temat e studentëve. Udhëheqësit e punimeve të Mikrotezës gjatë periudhës së përgatitjes së tij nga studenti mbajnë komunikim të vazhdueshëm duke i orientuar përgjatë kësaj kohe. Roli udhëheqës i pedagogut është këshillues dhe orientues lidhur me përmbylljen e objektivave të qëllimit të punimit, shfrytëzimin e literaturës bashkëkohore nga studenti dhe përfshirja e analizës teorike praktike në punim.</p> <p>Nga takimi me studentët e këtij programi, u evidentua bashkëpunimi deri në këtë fazë afër përmbylljes të realizimit të punimit të mikrotezës me udhëheqësin e punimit. Kjo manifestohet në ndjekjen sistematike dhe këshillat e vazhdueshme për studentët, duke filluar që nga faza e konceptimit. Rol të rëndësishëm ai ka në asistencën që jep sidomos me metodologjinë e punimit që është kyçi i një punimi të suksesshëm dhe sidomos në aspektin e aplikimit të të dhënave të siguruara. Në rastin e punimeve të Mikrotezës për studentët e këtij programi synohet që ai në strukturë trajtimi aplikativ të zërë një peshë të konsiderueshme.</p>



	<i>Takim me stafin dhe studentet në institucion</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Gjatë përpunimit të të dhënave të punimit studentët kanë të gjitha mundësitë teknike dhe asistencën e nevojshme për të realizuar këtë fazë të rëndësishme të punimit në laboratorët që ofron institucioni, bibliotekën dhe çdo infrastrukturë të dobishme për ta.  <i>Takim me stafin dhe studentet në institucion</i>
<b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Komisioni i Provimit të Formimit bazuar në komponentët e vlerësimit të përcaktuara në formularin përkatës dhe të plotësuara nga pedagogu udhëheqës i punimit si dhe vlerësimin nga prezantimi i punimit para tyre bën vlerësimin e punimit të Mikrotezës me notë përfundimtare dhe i behet të ditur studentit në fund të seancës së mbrojtjes.  <i>Shtojca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i> <i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i> <i>Shtojca nr.14. Udhëzim për Përgatitjen dhe mbrojtjen e temës së diplomës</i>
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e saj të miratuar nga MASR. Diplomës i bashkëngjitet edhe lista e notave. GVJ verifikoi praktikën përkatëse lidhur me diplomimin e studentëve në këtë program që i përket vitit akademik 2022-2023. në rast se studentit kërkon dhe kopje të programit të studimit me përmbajtjen lëndore me kërkesën e tij ai pajiset me këtë dokumentacion brenda afatit të caktuar në rregullore kundrejt pagesës së tarifës.  <i>Shtojca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i> <i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet.</i> <i>Shtojca nr.83.Formati i Diplomës MP në FK</i> <i>Shtojca nr.84.Modeli suplement i diplomës MP në KF</i>  <i>Takim në sekretarinë e institucionit</i>
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Nga vizita në institucion rezulton se procesi i ruajtjes së gjithë dokumentacionit bazohet në kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. Gjithashtu të dhënat e tij ruhen edhe në sistemin informativ të institucionit.  <i>Shtojca nr. 12. Rregullore e Arkiv Protokollit</i>  <i>Takim në sekretarinë e institucionit</i>





<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se institucioni ka një procedure të qarte të detyrimeve përmblyëse të studenteve dhe i pajis ata me dokumentacionin e nevojshëm në përfundim të programit. Ky standard plotësohet plotësisht</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.6

**Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Bazuar në RVB të programit të studimit, pasqyrat anekse të tij dhe vizitën në ambientet e FE konstatuam që në dispozicion të studenteve janë 2 laboratorë informatike të pajisur me kompjuteri përkatëse. Në to zhvillohen punët laboratorike të lendeve kryesisht aplikative (kryesisht të kontabilitetit) si dhe përgatitja e raportit të praktikës profesionale të tyre. Bazuar në numrin e studenteve në këtë program mjediset e laboratorëve janë të përshtatshme për të realizuar këto qëllime. <i>Shtojca : Pasqyrat anekse të RVB, tabela nr.16</i> <i>Vizita e eksperteve të jashtëm në ambientet e FE.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Bazuar në listën e marrëveshjeve që ka institucioni me institucionet publike e private dhe aktore të biznesit behet e mundur edhe realizimi i praktikës profesionale të studenteve të programit pranë tyre.. Kjo praktike profesionale realizohet në semestrin e dytë të vitit akademik dhe zgjat 3 muaj. Kjo ka qene edhe premise që një pjese e studentëve të punësohen pranë këtyre institucioneve apo aktoreve të biznesit. <i>Shtojca nr.37. Marrëveshjet e bashkëpunimit të KUL me bizneset</i> <i>Shtojca nr.38. Marrëveshjet e bashkëpunimit të KUL me institucione jo arsimore</i>
<b>Kriteri 3.</b> Praktikave profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e	Bazuar në planin mësimor të programit dhe akteve rregullative të institucionit vlerësohet me 6 kredite. Bazuar në procedure përkatëse student mbron punimin e praktikës përpara një komisioni prej dy pedagogesh që caktohen me vendim të përgjegjës të DFK. <i>Shtojca nr.2. Rregullore e Përgjithshme e KUL</i>




shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	<i>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Kontabilitet</i> <i>Shtojca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit MP në FK</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ evidenton se institucioni ofron kushtet optimale për të përcjellë njohuritë e programit të studimit nëpërmjet praktikave laboratorike dhe siguron realizimin me sukses të praktikës profesionale të studenteve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit,	Vihet re se, për vitin akademik 2021-2022, Departamenti Financë-Kontabilitet si njësi përgjegjëse e programit ka patur të angazhuar 5 (pesë) personel akademik efektiv. Personeli akademik kryen veprimtari mësimdhënëse, kërkim shkencor ose të zbatuar, shërbime për zhvillimin e Kolegjit Universitar “LOGOS”, këshillim për studentët, udhëheqje punimesh vjetore ose diplomash dhe detyra administrative. Po kështu, Drejtuesi i Departamentit Financë-Kontabilitet, që prej vitit 2021, ka marrë gradën shkencore Profesor Doktor nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë. Rezulton se, Përgjegjësi i Departamentit, duke vlerësuar dhe njohur specializimin e secilit personel akademik dhe bazuar në studimet dhe përvojat ndër vite në aktivitete kërkimore-shkencore, organizon shpërndarjen e lëndëve të personelit akademik. Nga shqyrtimi i CV-ve të personelit akademik të angazhuar në Departamentin Financë-Kontabilitet dhe kurrikulës së programit të






<p>natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>studimit, GVJ konstaton se çdo lëndë jepet nga një staf akademik që ka një specializim për këtë fushë. (Shtojca nr. 29: CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Financë-Kontabilitet; Tabela 12)</p> <p>Gjithashtu, anëtarët e stafit akademik që mbulojnë programin e studimit Master Profesional në “Financë Kontabilitet”, kanë nivel kualifikimi dhe fusha formimi akademike-kërkimore, të përgjithshme dhe specifike në përputhje me natyrën dhe specifikën e moduleve të programit të studimit. Përveç kësaj, diplomat e tyre, përvoja e tyre e mëparshme akademike dhe aktivitetet akademike gjatë punësimit në Departamentin Financë-Kontabilitet, hulumtimet dhe botimet e viteve të fundit të personelit akademik, dëshmojnë për specializimin dhe përshtatshmërinë e tyre për këtë program studimi. (Shtojca nr. 30: Të dhënat për kualifikime kërkim shkencor të stafit për 3 vitet e fundit ; Tabelat nr.19, 20)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>KU “Logos” ka lidhur një marrëveshje me MASR (Shtojca nr. 28: Marrëveshje MASR me KU “Logos” për reduktimin e numrit të personelit akademik), neni 3, pika 2: sipas së cilës, numri i personelit akademik efektiv në njësinë bazë, është 5, nga të cilët 4 janë me grada dhe neni 3, pika 4: ngarkesa mësimore e stafit akademik me kohë të plotë është më shumë se 70% e ngarkesës mësimore totale (Grup tabelat 4.1-4.4: Ngarkesa totale e personelit akademik sipas programeve në një vit akademik).</p> <p>GVJ konstaton se, personeli akademik i angazhuar në zbatimin e programit të studimit (efektiv dhe me kontratë), plotëson kërkesat ligjore në fuqi. Për vitin akademik 2021-2022, Ne zhvillimin e këtij programi janë angazhuar 6 PAE (2 staf akademik me titullin Profesor Doktor, 2 staf akademik me titull Doktor, 2 Asistent-lektor me titull Msc ku një prej tyre është në proces doktorature, dhe 4 personel akademik me kontratë (3 staf akademik me titull Profesor Doktor dhe 1 staf akademik me titull Doktor ). Pesha specifike e ngarkesës mësimore te PAE ndaj gjithë ngarkesës ne auditor (përfshirë praktiken profesionale dhe detyrimin përmbyllës është 70 % (420/600), pra ne kufirin e lejuar. Nëse bëjmë këtë raport pa përfshirë këto dy element kjo peshe specifike është 63 % (300/480).</p> <p>Sipas kuadrit ligjor në fuqi, ngarkesa mësimore vjetore e stafit akademik caktohet me vendim të Senatit Akademik, (Tabela nr.1.4; Grup Tabelat 12).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë</p>	<p>Kolegji Universitar “Logos” siguron menaxhimin efikas të Burimeve Njerëzore, nëpërmjet autoriteteve dhe organeve</p>






<p>qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>drejtuese, si dhe me anë të koordinimit nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Zyra e Burimeve Njerëzore, koordinon procedurat e rekrutimit të personelit akademik, në bashkëpunim të vazhdueshëm me njësinë bazë dhe atë kryesore, duke zbatuar Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë dhe kuadrin ligjor në fuqi. Ruajtja dhe përditësimi i dokumentacionit të personelit akademik administrohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Arkiv-Protokollit</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se, kontrata individuale e punës rregullon Marrëdhëniet ndërmjet Kolegjit Universitar “LOGOS” dhe punëmarrësit. (Shtojca nr 39. Kontratë individuale e punës për personelin akademik). Me qëllim menaxhimin, monitorimin e vlerësimin sa më objektiv e efikas të burimeve njerëzore, kontrata është e konceptuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe përmban përshkrimin e detyrimeve, funksioneve dhe proceseve të punës sipas pozicionit dhe funksionit përkatës. Përsa i takon personelit akademik efektiv, hartohet dhe Marrëveshja për organizimin kohor të punës, në përputhje me Udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018, të MASR, si shtojcë e kontratës. (Shtojca nr. 41: Marrëveshje kohore e punës me shtojcë kontrate për stafin akademik të KU “Logos”)</p> <p>Sipas (Shtojca nr. 31: Mobilitete të stafit akademik në kuadër të Erasmus +; Shtojca nr. 45: Trajnime nga institucioni për mësimdhënien; Shtojca nr. 115: Mbështetja e institucionit për stafin akademik), vihet re se Kolegji Universitar “Logos” ka në fokusin e tij, politika integruese të personelit akademik.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të personelit akademik parashikohen në Statutin dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Kolegjit Universitar “LOGOS”. Çdo fillim viti akademik, njësi bazë konstaton nevojën për personel të ri akademik, dhe më tej pas miratimit nga Dekanati, kërkesa përcillet tek Rektori i Kolegjit Universitar “LOGOS”. Në vijim, ngrihet komisioni ad-hoc nga njësi bazë për rekrutimin e personelit, i cili miratohet nga Dekani. Administratori i Institucionit, propozon një anëtar (përfaqësues i Zyrës së Burimeve Njerëzore) dhe pas miratimit përfundimtar nga Rektori, në bashkëpunim me Zyrën e Burimeve Njerëzore ndiqen procedurat e rekrutimit. Si fillim shpallen vendet vakante të miratuara dhe më pas organizohet procedura e konkurrimit nëpërmjet dosjes së kandidatëve dhe intervistës ballë për ballë. Vlerësimi kryhet nëpërmjet tabelës së pikëzimit të kandidatëve ku 40 % të vlerësimit e zë intervista.</p>

	<p>Pas përfundimit të procesit të konkurrimit, Zyra e Burimeve Njerëzore, njofton kandidatët përkatës nëse janë shpallur fitues ose jo.</p> <p>Kontrata individuale e punës dhe anekset e saj, të cilat hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet ligjore në fuqi, rregullon marrëdhëniet e punës të stafit.</p> <p><i>Evidenca nr. 1. Statuti i Kolegjit Universitar "LOGOS", neni 23 &amp; 24</i></p> <p><i>Evidenca nr. 2. Rregullore e përgjithshme e Kolegjit Universitar "LOGOS"</i></p> <p><i>Evidenca nr. 42. Politika dhe procedura e Burimeve Njerëzore në KU "Logos" Shtojca nr. 43. Paketë rekrutimi dhe përzgjedhjeje për personel akademik me kohë të plotë</i></p> <p><i>Evidencat nr. 39 dhe 40. Kontratë individuale e punës për personelin akademik dhe administrative</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në Kolegjin Universitar "LOGOS", GVJ konstatoi se angazhimi i personelit ndihmës në këtë institucion ishte në nivelet minimale për shkak edhe të numrit të kufizuar të studentëve.</p> <p>Aktualisht, studentët e programit të studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet", mund të përdorin laboratorin për orë laboratorike që janë parashikuar në lëndë të këtij programi, lëndë të fokusura në përfitimin e aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive informatike, etj.</p> <p><i>Evidenca nr. 24. Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet"</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit</p>	<p>Administrimi, ruajtja dhe përditësimi i dokumentacionit të personelit, ndihmës akademik dhe administrativ bëhet nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Arkiv-Protokollit, që gjithashtu harton dhe ndjek procedurat për rekrutimet e reja. Kjo zyrë, arkivon dosjet përkatëse për çdo anëtar të PAE dhe PAK dhe marrëveshjet kontraktuale të organizimit të kohës së punës të stafit akademik, bazuar kjo në kuadrin ligjor.</p> <p>Në mënyrë rastësore, GVJ shqyrtoi dosjen personale të dy pedagogëve të programit të studimit (një me kohë të plotë dhe një me kontratë) dhe konstatoi se dosja ishte e plotësuar me dokumentet e nevojshëm si: CV, kontrata e punës, diplomat dhe kualifikimet, etj.</p>

<p>akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p><i>Evidenca nr. 7. Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.</i>  <i>Evidenca nr. 12. Rregullore Arkiv – Protokolli</i>  <i>Evidenca nr. 42. Politika dhe procedura të Burimeve Njerëzore në KU “Logos”</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Praktika profesionale e studentëve, udhëhiqet dhe mbikëqyret nga personeli i kualifikuar, vënë dispozicion nga Departamenti Financë-Kontabilitet. Praktika profesionale zhvillohet pranë Institucioneve dhe kompanive të biznesit me të cilat Kolegji Universitar “LOGOS” ka marrëveshje bashkëpunimi dhe nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga Departamenti. Një aspekt i rëndësishëm i praktikës profesionale është fakti që i krijon mundësi studentëve, të krijojnë kontakte me përfaqësues të niveleve të ndryshme manaxheriale, të burimeve njerëzore, të identifikojnë fushat e tyre të interesit, të marrin pjesë aktivisht në funksione të ndryshme brenda kompanisë, sipas udhëzimeve nga mbikëqyrësi në vendin e praktikës, si dhe të ofrojë mbështetjen dhe rolin e tij modest.</p> <p>Çdo student që ndjek programin e studimit Master Profesional në “Financë-Kontabilitet”, duhet të përgatisë një mikrotezë me qëllim marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli studimi. Puna e tij kërkimore drejtohet nga një udhëheqës shkencor me përvojë akademike në fushën e ekonomisë, konkretisht në financë dhe kontabilitet. Për më tepër, titulli/grada shkencore që ai mban, garantojnë aftësitë e tij kërkimore-shkencore, në fushën në të cilën ofrohet programi i studimit dhe në të cilën parashikohet të hartohet mikroteza.</p> <p><i>Evidenca nr. 76. Dokumentet për praktikën profesionale për studentët e programit të studimit Master Profesional në “Financë-Kontabilitet”</i></p> <p><i>Evidenca nr. 36. Marrëveshje bashkëpunimi KU “Logos” me IAL brenda dhe jashtë vendit</i>  <i>Evidenca nr. 37. Marrëveshje bashkëpunimi KU “Logos” me bizneset</i>  <i>Evidenca nr. 38. Marrëveshje bashkëpunimi KU “Logos” me institucione joarsimore</i></p>





<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>				
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Personeli akademik që angazhohet në këtë program studimi ka nivelin e kërkuar të kualifikimit akademik për mësimdhënien në programin e studimit Master.</li> <li>- Pranë Departamentit Financë-Kontabilitet ka qëndrueshmëri të personelit akademik efektiv dhe atij të angazhuar në këtë program studimi.</li> <li>- Zyra e Burimeve Njerëzore mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit akademik të angazhuar me kohë të plotë dhe me kontratë.</li> <li>- KU "Logos" ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e praktikave profesionale dhe ka përgatitur udhëzues për realizimin dhe vlerësimin e praktikës profesionale dhe të temës së diplomës.</li> </ul>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi IV.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në Kolegjin Universitar "Logos", GVJ konstatoi se programi i studimit "Master Profesional në Financë-Kontabilitet" e zhvillon aktivitetin mësimor në Kampusin Nr. 1 të Kolegjit Universitar "Logos" me vendndodhje në adresën: Rruga "Dritan Hoxha",</p>



përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.

Pallatet “Komfort”, Tiranë, me sipërfaqe 5931 m<sup>2</sup>, sipas Kontratës së Huapërdorjes të Pasurisë së Paluajtshme, lidhur me Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë. Në ambientet e Institucionit, në shërbim të këtij programi studimi, në godinë janë në funksion një sallë në katin e pestë dhe laborator i informatikës në katin e katërt.

GVJ vlerëson se mjediset në këtë ndërtesë janë të mjaftueshme dhe të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e një procesi mësimor cilësor.

GVJ vizitoi disa salla leksionesh dhe seminaresh, bibliotekën dhe mjedise të tjera në përdorim të përbashkët dhe vuri re që mjediset, sipas funksionit të tyre, janë të pajisura me mjete elektronike e digjitale, që garantojnë realizimin në nivelin më të mirë të mundshëm të procesit mësimor teorik e praktik.

**GVJ evidentoi se kompjuterët rezultojnë pak të vjetruar dhe ndihet nevoja të zëvendësohen me pajisje të reja me karakteristika me të mira.**

Dokumentacioni i shqyrtuar vërteton se, objekti është ndërtuar me materiale cilësore dhe që plotëson standardet të sigurisë në punë dhe mirëqenien e stafit dhe studentëve.

*Evidenca nr. 46. Tabela e godinave të Kampuseve*

*Evidenca nr. 47. Inspektim Teknik*

*Evidenca nr. 48. Relacion mbi infrastrukturën*

*Evidenca nr. 49. Leje Higjiëno-Sanitare*

*Evidenca nr. 50. Kontratë Mbrojtja në punë*

*Evidenca nr. 52: Trajnim, Çertifikim për mbrojtje ndaj zjarrit, Plan evakuimi kampusi I*

*Shtojca nr. 53: Procesverbal inspektimi; Shtojca nr. 54: Raport Analizë e treguesve fiziko – kimikë).*

**Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e

<p>teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor, GVJ konstaton se programi i studimit “Master Profesional në Financë-Kontabilitet“ nuk ka kërkesa specifike për laboratorë të dedikuar dhe nuk parashikon realizimin e orëve të detyrueshme laboratorike.</p> <p>Në funksion të programeve të studimit të Fakultetit Ekonomik, rezulton laborator i informatikës në katin e katërt të kampusit (nga tre laboratorë të informatikës që ka kampusi 1). Ky laborator përmban 20 kompjutera funksionalë <b>por pak të vjetëruar</b>, të pajisur me programet e duhura që lehtësojnë procesin mësimor. Megjithatë, sugjerohet zëvendësimi i tyre me të rinj, për të mundësuar një cilësi më të lartë mësimdhënie.</p> <p>Gjithashtu rezulton se biblioteka e Kampusit Nr.1, është riorganizuar plotësisht në fund të vitit 2019, e rikonstruktuar dhe ka sipërfaqe 173 m. Biblioteka numëron 40 poste leximi dhe 18 poste të pajisura me kompjuter, të vëna në dispozicion të studentëve, të cilat mundësojnë aksesin në bibliotekën digjitale dhe aksesimin e materialeve të nevojshme për studim në funksion të realizimit të detyrave të kursit dhe temës së diplomës.</p> <p><i>Evidenca nr. 48. Tabela 16; Relacion mbi infrastrukturën</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet gjatë vizitës në Kolegjin Universitar “Logos“, GVJ konstatoi lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit në nivel institucioni me përfaqësues të institucioneve publike dhe jo-publike, të cilat mundësojnë edhe realizimin e praktikave profesionale të studentëve të këtij programi studimi në mjedise të përshtatshme.</p> <p>Kampusi nr. 1, ku zhvillohet programi i studimit Master Profesional në “Financë Kontabilitet”, ka mjedise të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e procesit mësimor dhe një pjese të praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike në funksion të programit të studimit.</p>

<p>veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p><i>Evidenca nr. 48. Tabela 16; Relacion mbi infrastrukturën Raporti i Vlerësimit të Brendshem.pdf; vizita në institucion</i>  <i>Evidenca nr. 36. Marrëveshje bashkëpunimi KU "Logos" me IAL brenda dhe jashtë vendit</i>  <i>Evidenca nr. 37. Marrëveshje bashkëpunimi KU "Logos" me bizneset</i>  <i>Evidenca nr. 38. Marrëveshje bashkëpunimi KU "Logos" me institucione joarsimore</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- KU "Logos" ka ambiente të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive mësimore.</li> <li>- Klasat e leksioneve dhe të seminareve dhe ambientet e tjera janë të pajisura relativisht me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një proces mësimor bashkëkohor.</li> <li>- Në dispozicion të studentëve është 1 laborator informatike dhe ambiente të tjera në përdorim të përbashkët të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme në shërbim të tyre. Megjithatë GVJ evidentoi që kompjuterët janë disi të vjetër dhe institucioni duhet të zëvendësojë ato me kompjuterë të parametrave bashkëkohor të përshtatshëm për realizimin e punëve aplikative të programit.</li> </ul>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	


### Standardi IV.3

**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjediset të posaçme).**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në programet e lëndëve të programit të studimit "Master i Profesional në Financë-Kontabilitet", GVJ konstatoi se titujt e përfshirë në literaturën bazë dhe ndihmëse përmbushin objektivat e tij të studimit dhe u mundësojnë studentëve të marrin njohuritë e nevojshme të parashikuara në program.</p> <p>Tekstet bazë janë në gjuhën shqipe, kryesisht të autorëve shqiptarë, por edhe përkthime në shqip të autorëve të huaj.</p> <p>Në takimin me personelin akademik, GVJ mori konfirmimin se në fillim të çdo viti akademik, pedagogët bëjnë rishikimin dhe</p>




	<p>përditësimin e syllabuseve të lëndëve dhe secili departament paraqet propozimin për listën e librave të nevojshëm për procesin mësimor dhe që duhet t'i shtohen fondit të bibliotekës.</p> <p>Biblioteka e Kolegjit Universitar “Logos”, sipas kërkesave të departamenteve përkatëse në lidhje me programet e studimit, rezulton e pajisur me literaturë mësimore bazë dhe ndihmëse, në gjuhë shqipe dhe të huaj. Kjo literaturë bazë dhe ndihmëse vihet në dispozicion të studentëve të programit të studimit Master Profesional në “Financë-Kontabilitet” dhe garanton marrje dijesh e njohurish të nevojshme, në ndihmë të leksioneve, seminareve, laboratorëve për secilën lëndë në kurrikulën e programit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se Departamenti Financë-Kontabilitet ka pasur prioritet gjatë viteve 2019-2022, pasurimin e bibliotekës fizike dhe atë online me titujt e viteve të fundit. Organizimi i procesit mësimor online, i ka dhënë përparësi përfitimit nga marrëveshjet e lidhura me Universitete brenda dhe jashtë vendit, për të shfrytëzuar bibliotekat e tyre online me qëllim lehtësimin e punës së pedagogëve dhe studentëve.</p> <p><i>Evidenca nr. 59. Lista e titujve në bibliotekë për Fakultetin Ekonomik</i></p> <p><i>Evidenca nr. 24. Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në “Financë-Kontabilitet”</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se biblioteka ishte e pasur me literaturë fizike, në shqip dhe gjuhë të huaj, të disiplinave të ndryshme të nevojshme në mbështetje të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera. Biblioteka e kampusit Nr.1 me sipërfaqe 173 m<sup>2</sup>, me 40 poste leximi si dhe 18 poste të pajisura me kompjuter, është e rikonstruktuar dhe riorganizuar në fund të vitit 2019.</p> <p>Për programin e studimit Master Profesional në “Financë Kontabilitet”, biblioteka është e pajisur me tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhë shqipe apo të huaj, revista shkencore, e-libra, të cilat janë të mjaftueshme për këtë program studimi. Ky</p>






	<p>material mund të përdoret nga studentët për studimet dhe punën e tyre kërkimore.</p> <p>Gjithashtu, Kolegji Universitar “LOGOS” ofron akses në literaturën online të bibliotekës së Universitetit të Pireut, sipas bashkëpunimit me këtë Universitet: <a href="http://lib.unipi.gr/">http://lib.unipi.gr/</a>. Gjithashtu GVJ-së iu komunikua që, institucioni është në përfundim e sipër të marrëveshjes për përdorimin e bibliotekës së pasur digjitale online të Universitetit Aristoteli të Selanikut dhe Universitetit të Janinës.</p> <p><i>Evidenca nr. 59. Lista e titujve në bibliotekë për Fakultetin Ekonomik</i></p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët e këtij programi na u konfirmua se ata kanë mundësi të përdorin pa pagesë si literaturën fizike të disponueshme në bibliotekë por edhe bibliotekën elektronike, në ambientet e Kolegjit Universitar “LOGOS”. Falë marrëveshjeve të bashkëpunimit, institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik disa platforma të bibliotekave elektronike, fillimisht me Questia e aktualisht me JSTOR dhe EBSCO.</p> <p>Gjithashtu, nga komunikimi me Dekanin e Kolegjit Universitar “LOGOS” rezulton se Kolegji Universitar “LOGOS” ofron akses në literaturën online të bibliotekës së Universitetit të Pireut, në sajë të marrëveshjes që ka me këtë universitet dhe është drejt finalizimit të marrëveshjes për përdorimin e bibliotekës së pasur digjitale</p>




	<p>online të Universitetit Aristoteli të Selanikut dhe Universitetit të Janinës.</p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshem.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Studentët e programit të studimit Master Profesional në “Financë Kontabilitet”, kanë në dispozicion në biblioteka e kampusit ku zhvillohet mësimi për këtë program studimi, 18 poste të pajisura me kompjuter me akses në internet nga ku mund të kërkojnë literaturë të ndryshme.</p> <p>Përmes regjistrimeve në programin e katalogimit të përbashkët elektronik PLEIADES bazuar në standardin MARC 21, fondi i Bibliotekës paraqitet në bazën e të dhënave elektronike. Katalogu elektronik <a href="http://lib-orthodoxalbania.org">http://lib-orthodoxalbania.org</a> ndihmon cilindo në gjetjen e informacionit që disponon fondi i bibliotekës.</p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshem.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Nga vizita në institucion, pranë ambienteve të bibliotekës, u konstatua se biblioteka e Kolegjit Universitar “LOGOS” frekuentohet gjatë gjithë vitit, me përjashtim të ditëve të festave zyrtare, nga e hëna në të premte, gjatë orarit 08:00-20:00.</p> <p>Studentët kanë të drejtën të anëtarësohen në bibliotekë dhe të përdorin në mjediset e bibliotekës, literaturën fizike dhe elektronike. Gjithashtu iu mundësohet të huazojnë literaturën që u duhet, jashtë mjediseve fizike të bibliotekës.</p> <p><i>Evidenca nr. 8 Rregullore e Bibliotekës</i></p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshem.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit,</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe nga RVB, konstatohet se fondi i Bibliotekës, zotëron një fond me materiale shqip dhe në gjuhë të huaja nëpërmjet blerjeve, shkëmbimit, dhuratave dhe abonimeve, dhe se biblioteka ka një strategji të shkruar për përditësimin e tij.</p> <p>Zgjerimi i marrëveshjeve me universitete perëndimore për akses në bibliotekën e tyre digjitale, është pjesë e strategjisë së bibliotekës dhe ka si qëllim përmbushjen sa më cilësore të nevojave për programin konkret Master Profesional në “Financë Kontabilitet” dhe të gjithë programeve të studimit që ofron Kolegji Universitar “LOGOS”.</p> <p>Biblioteka ofron tekste shkollore për studentët.</p>




<p>shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Secili anëtar i stafit akademik, në fillim të çdo viti akademik i paraqet përgjegjësit të njësisë bazë, kërkesën me titujt e përditësuar të literaturës bazë dhe ndihmëse për realizimin e procesit mësimor sipas lëndëve përkatëse. Më pas, këtë kërkesë, përgjegjësi i njësisë bazë ia drejton koordinatores së bibliotekës për të bërë pasurimin e kësaj të fundit me titujt e rinj.</p> <p><i>Evidenca nr. 60. Kërkesa e Departamentit Financë-Kontabilitet drejtuar Bibliotekës për tituj të rinj</i>  <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm.pdf</i>  <i>Vizita në institucion</i>  <i>Evidenca nr. 62. Strategjia e bibliotekës 2019-2023</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Literatura bazë dhe ndihmëse e programit përmbushin objektivat e tij të studimit dhe u mundësojnë studentëve të marrin njohuritë e nevojshme të parashikuara në program.</li> <li>- Biblioteka ofron infrastrukturën e nevojshme për akomodim dhe shfrytëzim në mënyrë të barabartë nga studentët dhe pedagogët e të gjithë programeve të studimit të Kolegjit Universitar "LOGOS".</li> </ul>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe nga diskutimet me strukturat përkatëse, rezulton se Kolegji Universitar "Logos" në bashkëpunim me zyrën e IT-së mundëson infrastrukturën elektronike, nëpërmjet platformave të ndryshme të aksesueshme lehtësisht online, në mbështetje dhe në lehtësimin e komunikimit ndërmjet stafit akademik, ndihmës akademik, si dhe studentëve të programit të studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet". Për ruajtjen e sigurtë dhe afatgjatë të të dhënave dhe zbatimin e një plani rikuperimi angazhohet Zyra e IT-së.</p> <p>Kolegji Universitar "LOGOS" operon me sistemin Edupage për të mundësuar informacion në lidhje me vlerësimin e studentëve dhe GVJ konstatoi se ai ndërtohet dhe reflektohet në bazë të kategorive</p>




	<p>të pikëve sipas zërave përkatës të paraqitur në syllabuset e lëndëve. Studentët me anë të llogarisë së tyre, mund të aksesojnë vlerësimet në kohë reale dhe në mënyrë konfidenciale. Gjithashtu, kopje të këtyre të dhënave, sipas komunikimit me sekretarinë mësimore, ruhen në format xlsx si backup i shpërndarë në kompjutera lokalë dhe në cloud.</p> <p>GVJ evidentoi se sekretaria mësimore e Fakultetit Ekonomik, me ndihmën e këtij sistemi gjeneron dhe ruan statistika vjetore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas programeve të studimit dhe cikleve të studimit;</li> <li>• të dhëna për transferimet dhe çregjistrimet;</li> <li>• të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit vit akademik;</li> <li>• të dhëna për ecurinë akademike të studentit;</li> <li>• numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik,</li> <li>• të dhënat e studentëve që diplomohen, etj.</li> </ul> <p><i>Evidenca nr. 63: Manual i përdorimit të Platformës Edupage</i>  <i>Evidenca nr. 64: Procedurat fillestare të një sistemi sigurie, shpërndarjeje të dokumentacionit të institucionit, Kopje Sigurie në Google Drive</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se Kolegji Universitar “LOGOS” operon me një sistem efikas të informimit. Sipas natyrës, burimit të tij si dhe destinacionit, informacioni kategorizohet në informacion të hapur për publikun si dhe informacion të brendshëm, që shpërndahet sipas funksionit tek organet e institucionit, zyrat përkatëse dhe studentët.</p> <p>Edupage përdoret nga studentët, stafi e sekretaria mësimore si sistem i implementuar për informacion të brendshëm, i cili përcillet në mënyrë të menjëhershme dhe të sigurtë, nga njëri pjesëtar i institucionit tek tjetri.</p>



	<p>Një rol kyç për administrimin e informacionit, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik e personelit administrativ rezulton të ketë, Zyra e Burimeve Njerëzore dhe arkiv-protokollit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Kolegji Universitar “Logos”, përdor në mënyrë aktive paketën Microsoft Office 365 Academic, e cila kujdeset për bazën e të dhënave dhe sistemin Microsoft Teams. Ky i fundit mundëson arkivimin e leksioneve, detyrave, provimeve dhe çdo linje tjetër komunikimi ndërmjet stafit akademik dhe studentëve. Nga takimi me stafin akademik, rezultoi se kjo platformë, gjatë periudhës së mësimit online, por edhe në vijim, luan një rol të rëndësishëm, në garantimin e ecurisë së procesit mësimor dhe cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>GVJ konstatoi se sekretaria mësimore mban në sistem edhe të dhëna personale të studentëve si numra telefoni, adresa email-i dhe ruan kontakte të vazhdueshme me studentët në raste njoftimesh, gjithmonë duke zbatuar rregulloren e posaçme për ruajtjen dhe përdorimin e të dhënave personale.</p> <p><i>Evidenca nr. 66: Manuali i mësimdhënies online</i>  <i>Evidenca nr. 65: Udhëzues në nivel institucional, metoda inovative të mësimdhënies</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet me sekretarinë, stafin akademik dhe studentët në Kolegjin Universitar “Logos”, GVJ konstatoi se Edupage &amp; Microsoft 365 garantojnë monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ. Platforma Microsoft Teams, disponon të gjithë materialin mësimor, leksionet e zhvilluara, detyrat e studentëve etj, dhe lehtëson në këtë mënyrë raportimin në kohë reale tek organet drejtuese dhe titullarët me qëllim mbarëvajtjen e procesit mësimor. Të gjitha këto statistika dhe të dhëna rezultojnë të vlefshme vetëm për llogarinë e administratorit të sistemit dhe llogari të tjera të autorizuara.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit të Kolegjit Universitar “LOGOS” <a href="http://www.kulogos.edu.al">http://www.kulogos.edu.al</a>, e cila ofrohet në dy gjuhë (shqip dhe anglisht), janë publikuar të dhëna në lidhje me strukturën organizative, veprimtaritë, bazën ligjore si dhe njoftimet të ndryshme që lidhen me veprimtarinë akademiko-shkencore, sociale, etj, duke shërbyer si informacion i hapur për publikun dhe çdo subjekt të interesuar.</p> <p>GVJ evidentoi se në faqen zyrtare, KU “Logos” publikon informacion në lidhje me ofertën akademike, kriteret e pranimit,</p>





	përbajtjen e programeve të studimit, informacione mbi stafin akademik të grupuar sipas departamenteve dhe fakulteteve, informacione e kontakte të nevojshme me zyrat administrative, orarin mësimor, orarin e provimeve, njoftime për veprimtari të ndryshme profesionale, sociale, argëtuese, akademike etj.			
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- KU "Logos" mundëson infrastrukturën elektronike, nëpërmjet platformave Edupage dhe Microsoft 365, të cilat janë të aksesueshme lehtësisht online dhe garantojnë monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ.</li> </ul> <p>Zyra e IT-së angazhohet për ruajtjen e sigurtë dhe afatgjatë të të dhënave dhe zbatimin e një plani rikuperimi.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**


<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në Kolegjin Universitar "Logos", GVJ konstatoi se, Kolegji Universitar "LOGOS", harton buxhetin në përputhje me politikat e përgjithshme të zhvillimit dhe me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Bazuar në nevojat e institucionit, sipas strategjisë së zhvillimit që ndjek dhe zbaton Kolegji Universitar "LOGOS", bëhet shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre në përputhje me natyrën e shërbimeve të ofruara.</p> <p>KU "Logos" harton projektbuxhetin në përputhje me planin strategjik të zhvillimit, nevojat dhe interesat e institucionit duke pasqyruar dhe kërkesat e njësive bazë dhe kryesore.</p> <p>Kolegji Universitar "LOGOS", siguron të ardhura të mjaftueshme në formën e donacioneve nëpërmjet Fondacionit "Logos", përveç fondeve që arkëton nga tarifat e studentëve. Në këtë mënyrë, GVJ konstatoi se, Kolegji Universitar "LOGOS" garanton qëndrueshmëri financiare.</p> <p><i>Evidenca nr. 68: Projektbuxheti 2020-2024</i>  <i>Evidenca nr. 69: Sugjerimet e njësive bazë mbi përpilimin e Projekt-Buxhetit</i></p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet</p>	<p>Nga (Tabela 18), vihet re se plani i financimit hartohet në rang institucional dhe përmban në këtë mënyrë, financimin në total të burimeve njerëzore për të gjithë programet e studimit që ofron Kolegji Universitar “LOGOS”, shërbimet operative për mirëmbajtjen, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për studime e bursa, shpenzimet për bibliotekën, detyrimet financiare, grandet vendase apo të huaja të përfituara, etj.</p> <p>GVJ konstatoi se institucioni monitoron në mënyrë të vazhdueshme nevojat e njësisë bazë për pasurimin e ofertës akademike e vërtetueshme kjo, nëpërmjet aplikimit për hapjen e programeve të reja dhe për mbarëvajtjen e programeve të studimit aktuale. Gjithashtu mbulon kostot për sigurimin e burimeve njerëzore, infrastrukturës së përcaktuar, pasurimit e fondave të</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Bazuar në takimet e GVJ me strukturat përgjegjëse të KU “Logos”, u konstatua se Administratori dhe Zyra e Financës monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e planit financiar të miratuar, në mbështetje të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 dhe kuadrit rregullativ të brendshëm, në mënyrë që të sigurohet një përdorim efektiv e i auditueshëm i aktivitetit financiar.</p> <p>Bordi Drejtues i Fondacionit përcakton/përzgjedh një Ekspert Kontabël të Autorizuar (në kuadër të auditimit financiar i detyrueshëm të kryhet për çdo vit kalendarik-financiar), i cili realizon procedurën e auditimit të jashtëm të institucionit në zbatim të standardeve ndërkombëtare të auditimit, të pasqyrave financiare, si dhe bën paraqitjen e analizave të këtyre të fundit.</p> <p>Duke u mbështetur në dokumentacionin shoqëruar dhe atë të vënë në dispozicion gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Kolegji Universitar “LOGOS” depoziton pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, pasqyrat financiare të bashkëshoqëruara me Raportin respektiv të Auditimit të përgatitur nga Eksperti i pavarur Kontabël. Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton më tej se, Raporti i veprimtarisë financiare është pjesë përbërëse e raportit vjetor të aktivitetit të institucionit dhe personeli akademik është pjesëmarrës aktiv sipas departamenteve në përpilimin dhe miratimin e tij. Rezulton se deri më tani, Kolegji Universitar “LOGOS” nuk ka aplikuar qasjen e prezantimit tek studentët të Raportit të veprimtarisë financiare, gjë që ndikon direkt në rritjen e transparencës së institucionit. Por, përfaqësuesit e studentëve në Senat marrin pjesë në diskutimet e raportit vjetor.</p> <p><i>Evidenca nr. 69: Raport i Auditimit 2019, 2020, 2021</i></p>




	<p><i>Evidenca nr. 21: Raporti Vjetor Institucional për vitet akademike: 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</i></p> <p><i>Evidenca nr. 17: Përbërja e Senatit Akademik, Vendimi Nr 23 datë 30.10.2020</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Gjatë vitit, Institucioni bën ndjekjen periodike të realizimit të buxhetit. Përveç Raportit Financiar në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, u vu re se institucioni dokumenton raportet financiare të viteve të kaluara akademike dhe bën një analizë krahasuese të zërave të buxhetit ndër vite. Në këtë mënyrë, planifikon ndërhyrjet e posaçme të financimit të institucionit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. Gjithashtu, GVJ-së iu komunikua se Institucioni bën axhustimin e buxhetit afatmesëm (3-vjeçar) çdo vit dhe raporton për çdo ndryshim qoftë në realizim ose mosrealizim të zërave përkatës të buxhetit, duke argumentuar secilën situatë tek organet përkatëse.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Kolegji Universitar “LOGOS” rezulton të ketë siguruar një stabilitet financiar si pjesë e Fondacionit “Logos”, nëpërmjet themeluesit të tij (Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë), i cili e mbështet dhe inkurajon funksionimin normal lidhur me veprimtarinë kërkimore – shkencore dhe edukative të tij.</p> <p>Burimet e të ardhurave të Institucionit rezultojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Financimi i Fondacionit Logos.</li> <li>• Të ardhurat nga tarifat e studimit të studentëve.</li> <li>• Financime dhe donacione të tjera.</li> </ul> <p>GVJ konstaton se në aktin e themelimit dhe statutin e Fondacionit “LOGOS” përcaktohet qartë karakteri edukativo-mësimor dhe jofitimprurës i tij. Kjo pasqyrohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• tarifat e shkollimit për të gjitha programet e studimit,</li> <li>• akordimin e bursave të studimit dhe ndihmave studentëve në nevojë</li> <li>• ndarjen në këste të pagesës vjetore, për të lehtësuar sa më shumë ngarkesën ekonomike të studentëve.</li> </ul> <p>GVJ konstatoi se, përgjatë periudhës së vështirë të pandemisë, Kolegji Universitar “LOGOS” siguroi qëndrueshmëri financiare dhe mori çdo mjet të nevojshëm financiar nga Fondacioni me qëllim likuidimet e plota e në kohë të pagave për personelin akademik dhe administrativ, përballimin e shpenzimeve për ngritjen e klasave virtuale të pajisura me të gjithë teknologjinë e nevojshme për sigurimin e procesit mësimor sa më cilësor, e deri tek mbështetja financiare për mjete e akses në internet për studentët në nevojë.</p>






	Evidenca nr. 69: Raport i Auditimit 2019, 2020, 2021			
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- KU "Logos" harton buxhetin në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe me politikat e përgjithshme të zhvillimit.</li> <li>- KU "Logos" përveç fondeve që arkëton nga tarifat e studentëve siguron të ardhura të mjaftueshme në formën e donacioneve nëpërmjet Fondacionit "Logos".</li> <li>- Rezulton se fondet që krijohen nga të ardhurat e studentëve mundësojnë ndërmarrjen me transparencë të plotë, të veprimeve në drejtim të rritjes së cilësisë së mësimdhënies.</li> <li>- KU "Logos" garanton qëndrueshmëri financiare.</li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


<b>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstatoi se pranimi i studentëve në ciklin e dytë të studimeve "Master profesional në Financë Kontabilitet" bëhet në përputhje me kriteret e pranimin të përcaktuara në ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në Statutin, Rregulloren e përgjithshme të KU "LOGOS" dhe rregulloren mësimore të programit "Master Profesional në Financë Kontabilitet".</p> <p>Departamenti Financë Kontabilitet kryen listimin e më pas përzgjedhjen e kandidatëve fitues në përputhje me kuotat e miratura, mbi bazën e dokumentacionit të sipërpërmendur. Kolegji Universitar "LOGOS" ndjek të gjitha procedurat dhe kriteret e</p>


	<p>përcaktuara në aktet rregullatore të Ministrisë dhe agjencive kompetente në varësi të saj (QSHA, RASH), në procesin e sipërpërmendur.</p> <p><i>Evidenca nr. 70. Vendim për kriteret e pranimit në programin e studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet"</i></p> <p><i>Evidenca nr. 71. Renditja e studentëve fitues në programin e studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet" për vitet akademike: 2020-2021, 2021-2022</i></p> <p><i>Evidenca nr.5 Rregullore e Programit të Studimit Master profesional në Financë-Kontabilitet</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Rezulton se, barazia dhe shanset e barabarta janë parime të parashikuara për studentët e përzgjedhur përgjatë dhe pas studimeve të tyre, në zbatim të Nenit 10 të Rregullores së Kolegjit Universitar "LOGOS", i cili parashikon se : "Personeli i Kolegjit Universitar "LOGOS" gjatë kryerjes së detyrave të tij nuk mund të bëjë diskriminime mbi baza etnike, gjuhësore, racore, politike, mendimi, filozofike, dhe fetare."</p> <p>Informacioni është transparent në faqen zyrtare të Kolegjit Universitar "LOGOS" <a href="http://www.kulogos.edu.al">www.kulogos.edu.al</a> .</p> <p>Bazuar në diskutimin me personelin akademik, Departamenti rishikon herë pas here politikat e pranimit të studentëve në programin e studimit "Master profesional në Financë Kontabilitet". Studentët e këtij programi studimi, informohen në mënyrë të vazhdueshme për përmbajtjen dhe format e tij, metodat e vlerësimit, afatin e përfundimit deri në diplomimin e tyre,.</p> <p><i>(Shtojca Nr. 2 Rregullore e përgjithshme e KU "LOGOS", Neni 10, Shtojca Nr. 88 _ Leksione të Hapura KU LOGOS 2019-2022, Shtojca Nr. 89 Mjetet e komunikimit me studentët, Shtojca Nr. 90 Materialet dhe broshurat informuese për studentin, Fletëpalosja dhe Broshura e KU "LOGOS" në shqip, Shtojca Nr. 91 Pranimi i studentëve të rinj- aktivitetet, Shtojca Nr. 93 _ Open Days, Shtojca Nr 95 _ Pjesëmarrja në Panairt e Punës 2019-22).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se KU "Logos" jep informacion për kandidatët për studentë, lidhur me kriteret, procedurat e pranimit, procesin e transferimeve të studimeve, i cili bëhet publik në mjediset e tij dhe në faqen elektronike zyrtare. Përpos kriterëve të veçanta, studentët që dëshirojnë të ndjekin programin e studimit Master Profesional në Financë Kontabilitet, pranë KU LOGOS, duhet të zotërojnë diplomë universitare "Bachelor " dhe të kenë grumbulluar gjithsej 180 kredite, ECTS. Programi Master</p>




<p>ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Profesional në Financë Kontabilitet nuk e ka detyrim ligjor mbrojtjen e gjuhës angleze.</p> <p>Kolegji Universitar “LOGOS” përdor një larmi mjedesh informimi për publikun për të bërë komunikimin e kriterëve, procedurave të pranimit dhe të transferimit, si: faqja zyrtare e institucionit, fletëpalosjet, leksione të hapura dhe lojra interaktive në disiplinat ekonomike, broshurat informative, ditët e informimit dhe këshillimit të karrierës, ditët e hapura si dhe ditët e karrierës.</p> <p><i>(Shtojca Nr. 88 Leksione të Hapura KU Logos 2019-2022, Shtojca Nr. 89 Mjetet e komunikimit me studentët, Shtojca Nr. 91 Materialet dhe broshurat informuese për studentin, Fletëpalosja dhe Broshura e KU “LOGOS” në shqip, Shtojca Nr. 91_ Pranimi i studentëve të rinj, aktivitetet, Shtojca Nr. 93 Open Days,).</i></p> <p><i>(Shtojca Nr 72 Vendim Nr. 10 -Politika e arsimit në distancë, Shtojca Nr. 72 Udhëzim 12 për vijimin dhe mbylljen e vitit akademik 2019-2020, Shtojca Nr. 74 Vendim për vijimin dhe mbylljen e vitit akademik 2019-2020, Shtojca Nr 94 Rrjetet sociale, Shtojca Nr. 64 Udhëzues në nivel institucional, metoda inovative të mësimdhënies.)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kolegji Universitar “LOGOS”, ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, ndërmjet programeve të të njëjtit cikël studimesh të institucioneve të tjera të arsimit të lartë. Transferimi lejohet brenda të njëjtit cikël studimi e në fusha studimi të njëjta ose të ngjashme dhe vetëm në fillim të vitit akademik brenda Fakultetit Ekonomik të KU LOGOS. Një komision ad-hoc i ngritur nga departamenti Financë Kontabilitet pranë Fakultetit Ekonomik, merr vendimet për njohje të plotë ose të pjeshme të krediteve të fituara në institucione të tjera. Në bazë të kriterëve dhe kuotave të propozuara dhe të miratuara për çdo program studimi, të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit, bëhet pranimi i studentëve për çdo vit akademik për ciklin e dytë të studimeve. Në këtë proces, u evidentuat se Kolegji Universitar “LOGOS” ndjek të gjitha procedurat dhe kriteret e përcaktuara në aktet rregullatore të Ministrisë dhe agjencive kompetente në varësi të saj (QSHA, RASH).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se, përpara fillimit të çdo viti akademik, Kolegji Universitar “LOGOS” bën publike kriteret e secilit program studimi në faqen e tij të web-it, si dhe në rrjetet sociale. Mënyra të tjera informuese realizohen nëpërmjet Panireve Work &amp; Study, fletëpalosjeve, programeve radiofonike</p>




<p>përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>në Radio Ngjallja, lajmërimeve televizive, takimeve të hapura dhe nëpërmjet komunikimeve të personelit akademik dhe jo vetëm etj. Kriteret, janë lehtësisht të aksesueshme dhe transparente për të gjithë kandidatët për studentë.</p> <p>Kolegji Universitar "LOGOS" organizon vizita informuese në ambientet e tij mbi ofertën akademike, programet e studimit, kriteret e pranimit, infrastrukturën në funksion të programeve, personelin akademik, mundësitë e punësimit, praktikat profesionale, bashkëpunimet me institucione, universitete brenda dhe jashtë vendit, shkëmbim eksperiencash studimi ndërkombëtare si Erasmus+, me shoqëri në sektorin privat dhe gjithashtu është pjesëmarrës çdo vit akademik në panairin e universiteteve organizuar në periudhën Shkurt-Maj.</p> <p><i>(Shtojca Nr. 95 Pjesëmarrja në Panairin e Punës, Shtojca Nr. 91 Pranimi i studentëve të rinj, aktivitetet, Shtojca Nr. 96. Aktivitetet e Fakultetit Ekonomik të KU "Logos" për vitet akademike 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022).</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>GVJ konstaton se, Kolegji Universitar "LOGOS" ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave në nevojë të cilët interesohen për të ndjekur programin e studimit Master Profesional në "Financë Kontabilitet". Kolegji Universitar "LOGOS" në bashkëpunim me Fondacionin LOGOS, në kuadër të mbështetjes së kësaj kategorie të studentëve, bën publike në mënyrë transparente oraret e pritjes së kandidatëve për studentë me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave në nevojë dhe plotëson dosjen për vlerësimin e kërkesës. Ky informacion publikohet në faqet zyrtare të institucionit si dhe në mjediset brenda tij.</p> <p><i>(Shtojca Nr. 88 Leksione të Hapura KU Logos 2019-2022, Shtojca Nr.89. Mjetet e komunikimit me studentët, Shtojca Nr. 90 Materialet dhe broshurat informuese për studentin, Fletëpalosja dhe Broshura e KU "LOGOS" në shqip, Shtojca Nr. 91. Pranimi i studentëve të rinj- aktivitetet, Shtojca Nr. 93 Open Days, Shtojca 95. Pjesëmarrja në Panairin e Punës).</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Kriteret e pranimit dhe kuotat, për secilin program studimi janë në përputhje me kudrin ligjor në fuqi. Në to parashikohet për çdo vit edhe pranimi i studentëve të huaj/troje nga shtete të tjera. Kolegji Universitar "LOGOS" informon dhe orienton në mënyrë korrekte dhe transparente, studentë të huaj/trojet të cilët interesohen për të ndjekur programin e studimit Master Profesional në "Financë Kontabilitet", në lidhje me procesin duke</p>




	<p>filluar nga njësimi i diplomave të huaja nga MASR deri tek aplikimi përfundimtar. GVJ evidentoi se është Departamenti Financë Kontabilitet, i cili ngre një komision ad-hoc për të përzgjedhur listën e kandidatëve dhe siguron respektimin rigoroz të kriterëve të transparencës, barazisë dhe të drejtave të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë</p> <p><i>(Shtojca Nr. 87 Vendim Rektorati për organizimin e fushatës së Informimit 2019-2022; Shtojca Nr. 71. Renditja e studentëve fitues në programin e studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet" për vitet akademike: 2020-2021, 2021-2022).</i></p>				
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>GVJ konstatoi se Kolegji Universitar "LOGOS" ndjek një politikë të ndihmës/bursave të plota për shtresat në nevojë. Gjithashtu, ofron bursa sociale për shtresat në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi, ofron bursa merite për studentë me rezultate të larta, të cilët interesohen për të ndjekur programin e studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet".</p> <p>Kolegji Universitar "LOGOS" bën publike në mënyrë transparente oraret e pritjes së kandidatëve për studentë të kësaj kategorie. Ky informacion publikohet në faqen zyrtare të institucionit si dhe në mjediset brenda tij në tabelat e buletinit.</p> <p><i>(Shtojca Nr. 88 Leksione të Hapura KU Logos 2019-2022, Shtojca Nr.89 Mjetet e komunikimit me studentët, Shtojca Nr. 90 Materialet dhe broshurat informuese për studentin, Fletëpalosja dhe Broshura e KU "LOGOS" në shqip, Shtojca Nr. 91 Pranimi i studentëve të rinj- aktivitetet, Shtojca Nr. 92 Open Days, Shtojca 95. Pjesëmarrja në Panaiet e Punës, Shtojca nr.106-Bursat e akorduara në programin e studimit Master Profesional në Financë-Kontabilitet të KU "Logos" në vitet 2019-2022).</i></p>				
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në programin e studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet" të KU "Logos" pranimi i studentëve çdo vit akademik kryhet në përputhje me kriteret dhe kuotat e propozuara dhe të miratuara, të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit.</li> <li>- KU "Logos" përdor mjete informimi për publikun për të bërë komunikimin e kriterëve, procedurave të pranimit dhe të transferimit</li> </ul>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="598 1823 790 1908">Nuk përmbushet</td> <td data-bbox="790 1823 997 1908">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="997 1823 1236 1908">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1236 1823 1482 1908">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Rregullores së Departamentit Financë Kontabilitet dhe Rregullores së programit të studimit Master Profesional në “Financë Kontabilitet” GVJ evidentoi se përmenden të gjitha kriteret për progresin e studentëve për të përmbyllur vitin akademik. Këto kritere janë të aksesueshme në web, në mënyrë verbale nga sekretaria mësimore dhe personeli akademik në auditor.</p> <p>Nga takimi me Zyrën e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës u konstatua se ajo organizon në fillimin e çdo viti akademik, për studentët e programit të studimit Master Profesional në Financë Kontabilitet, aktivitetin “Njihu me Kolegjin Universitar “LOGOS”.</p> <p>Rezulton se, Kolegji Universitar “LOGOS”, angazhon personelin akademik dhe administrativ për informimin dhe këshillimin e studentëve, nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta me studentët. Gjithashtu, Fakulteti Ekonomik i Kolegjit Universitar “LOGOS” organizon takime informuese me studentët e tij që janë duke përfunduar nivelin Bachelor për t’i orientuar për mundësitë e tyre për studime pasuniversitare në nivelin Master Profesional në Financë Kontabilitet. Këtë informacion studentët e marrin në mënyrë të vazhdueshme edhe nëpërmjet e-mail-it dhe kanaleve të tjera informuese të Kolegjit Universitar “LOGOS” si rrjetet sociale Facebook dhe Instagram dhe Platformat Microsoft Teams dhe Edupage.</p> <p><i>(Shtojca Nr. 4 Rregullorja e Departamentit të Financës Neni 34 Shtojca Nr.9 Rregullorja e sekretarisë mësimore, Shtojca Nr. 92 Orientimi dhe Këshillimi i studentëve tanë për kalimin në Ciklin e Dytë të studimeve).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të</p>	<p>Fakulteti Ekonomik i Kolegjit Universitar LOGOS, zbaton Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 dhe kriteret e sistemit të Bolonjës, në bazë të të cilave ofron mundësitë e njohjes së krediteve dhe transferimit të studimeve, midis programeve të njëjtë apo të ngjashëm të të njëjtit cikël studimi, brenda të njëjtit institucion apo</p>



<p>mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë. Në mbledhjen me përgjegjësin e Departamentit u evidentua se Departamenti Financë-Kontabilitet ngre komisione ad-hoc, të quajtur Komisionet për Transferim dhe Program të Dytë Studimesh, të cilat krijohen me vendim të Dekanit dhe miratohen nga Rektori i Kolegjit Universitar “LOGOS”.</p> <p><i>(Shtojca nr. 1: Statuti i KU “LOGOS”, Shtojca nr. 4: Rregullorja e Departamentit të Finance Kontabilitet, neni 19). (Shtojca nr. 79. Udhëzim për transferimet; Shtojca nr. 77: Vendim Dekanati FE për ngritjen e Komisionit për transferimet, Shtojca nr. 80. Template me të dhënat e të gjithë aplikantëve për transferim studimesh).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se, Kolegji Universitar “LOGOS ka në fokusin e tij mbarëvajtjen e mësimnxënies dhe informimin e vazhdueshëm të studentëve. Vlerësimi i dijeve bëhet nëpërmjet testeve të programuara në syllabus ( test i ndërmjetëm, test përfundimtar) e detyrave të kursit, duke aplikuar në këtë mënyrë, vlerësimin e vazhdueshëm. Përveç komunikimit verbal informimi bëhet dhe nëpërmjet platformave on line që KU LOGOS vë në përdorim. GVJ-së iu komunikua se, në javën e parë të çdo fillim semestri, lektori i lëndës informon studentët e programit të studimit Master Profesional në Financë Kontabilitet, në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve për çdo lëndë të përfshirë në planin mësimor, si dhe depoziton në platformën Microsoft Teams dhe Edupage Syllabusin për lëndën përkatëse.</p> <p>Gjithashtu, në ndihmë të informimit të studentëve, Institucioni rezulton të ketë vendosur në dispozicion dhe struktura të tjera si: koordinator, pedagogë për udhëheqjen e punimeve të diplomës, pedagogë udhëheqës për ndjekjen e praktikave profesionale.</p> <p><i>(Shtojca nr 24. Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në “Financë-Kontabilitet”; Shtojca nr. 26. Syllabuset e programit të studimit Master Profesional në “Financë-Kontabilitet”, Shtojca nr 44. Vendimi nr.25, datë 25.09.2021 i Dekanit FE për caktimin e Koordinatorëve sipas programit të studimit, Shtojca nr. 3 : Rregullore Fakulteti Ekonomik të KU LOGOS, Shtojca nr. 14. Udhëzim për Përgatitjen dhe Mbrojtjen e Temës së Diplomës; Shtojca nr 76. Dokumentat për praktikën profesionale për studentët e programit të studimit Master Profesional në “Financë-Kontabilitet”).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në</p>	<p>Departamenti Financë Kontabilitet, organizon takime informuese me studentët e programit të studimit Master Profesional "Financë</p>




<p>lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kontabilitet”, në lidhje me kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës. Gjithashtu studentët i kanë të aksesueshme këto kriteret dhe procedura si dhe templatën e punimit të diplomës edhe në klasat virtuale në platformën Microsoft TEAMS.</p> <p>GVJ konstatoi se Rregullorja e Departamentit Financë Kontabilitet parashikon të gjithë informacionin në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit Master Profesional "Financë Kontabilitet". Studenti nuk mund të mbrojë punimin e diplomës pa shlyer më parë të gjitha detyrimet akademike dhe pa fituar numrin e krediteve të parashikuara në planet mësimore të programit përkatës të studimit.</p> <p><i>(Shtojca nr_4 : Rregullorja e Departamentit të Finance Kontabilitet, Neni 42,43, 45, 46, 47, 48; Shtojca nr Shtojca nr. 14. Udhëzim për Përgatitjen dhe Mbrojtjen e Temës së Diplomës).</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Kolegji Universitar “LOGOS” organizon fushata të gjera informimi në web por jo vetëm, rreth 6 muaj përpara fillimit të çdo viti akademik, me qëllim njohjen e kandidatëve për studentë me ofertën akademike, institucionin, mënyrat e zhvillimit të procesit mësimor e formues të studentëve, praktikave profesionale, shkëmbimeve ndërkombëtare ERASMUS +. Për organizimin e fushatës së informimit në funksion të këshillimit të karrierës dhe rekrutimit të kandidatëve për studentë në Kolegjin Universitar “LOGOS” ngrihet grupi i punës siç rezulton nga <i>Shtojca nr. 87: Vendim Rektorati për organizimin e fushatës së Informimit 2019-2022.</i></p> <p>GVJ konstaton se, Kolegji Universitar “LOGOS” përdor një larmi mjetesh informimi për publikun ku mund të përmenden, faqja zyrtare e institucionit, fletëpalosjet, broshurat informative apo ditët e informimit dhe këshillimit të karrierës me studentët, ditët e hapura. Po kështu Kolegji Universitar “LOGOS”, fton vazhdimisht në ambientet e amfiteatrit të tij studentët potencialë, për të ndjekur aktivitetet që organizon në formën e leksioneve të hapura, me qëllim vendosjen e një marrëdhënie dialektike.</p> <p><i>(Shtojca nr 88. Leksione të Hapura KU “Logos” 2019-2022, Shtojca nr.96: Aktivitete KU Logos FE për vitet akademike 2019-2020,2020-2021,2021-2022;).</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në funksion të informimit dhe këshillimit të studentëve, KU “Logos” ka në përbërjen e tij Zyrën e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës.</li> </ul>






	<ul style="list-style-type: none"> <li>- KU "Logos", nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta me studentët, angazhon personelin e duhur akademik dhe administrativ për informimin e tyre.</li> <li>- Institucioni jep informacion të vazhdueshëm për studentin lidhur me procesin e transferimeve të studimeve, vlerësimin e dijeve, si dhe punimin e temës së diplomës, në bashkëpunim me njësitë kryesore.</li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>GVJ konstatoi se KU „Logos“ informon në mënyrë të hollësishme studentët në lidhje me programin e studimit Master Profesional në „Financë Kontabilitet“, nëpërmjet organizimit në çdo fillim viti akademik të aktivitetit Njihu me Kolegjin Universitar LOGOS. Gjithashtu, senatori i programit të studimit si pjesë e “Këshillit Studentor” dhe koordinatori i programit, shërbejnë për informimin e studentëve apo adresimin e problematikave të tyre në organet përkatëse. Një mjet tjetër i rëndësishëm informimi në kohë reale rezulton dhe faqja zyrtare e Kolegjit Universitar “LOGOS”, platforma EDUPAGE dhe Microsoft TEAMS, rrjetet sociale, komunikimi nëpërmjet adresave elektronike të pedagogëve dhe studentëve, ku studentët informohen lidhur me orarin mësimor, njoftimet mbi aktivitetet, workshope-t apo konferencat, leksione të hapura, oraret e konsultimeve nga pedagogët, informimi mbi syllabuset etj. Gjithashtu, rezulton se, Institucioni disponon mjete komunikimi të brendshme, si njoftime me postera të afishuara brenda institucionit, si dhe komunikim verbal në auditor.</p> <p>(Shtojca nr. 98: Njihu me Kolegjin Universitar LOGOS, Shtojca nr.99: Organizimi i zgjedhjeve të Këshillit Studentor; Shtojca nr.101: Financimi i veprimtarive të propozuara nga Këshilli Studentor; Shtojca nr.1: Statuti i KU “LOGOS” (Neni 40, neni 121). (Shtojca nr.89: Mjetet e komunikimit me studentët, Shtojca</p>




	nr. 96. Aktivitetet e Fakultetit Ekonomik të KU "Logos" për vitet akademike 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022)
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin shoqëruar dhe takimin me studentët e programit të studimit, GVJ konstatoi se për çdo fillim viti akademik, ata pajisen me dosjen e plotë të studentit, e cila përfshin kartën e studentit edhe informacion mbi syllabuset, modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Gjatë kohës së pandemisë, rezultoi se, kjo dosje u është dërguar studentëve në mënyrë elektronike. Gjithashtu, janë krijuar klasa virtuale për secilën lëndë dhe publikuar në platformat e miratuara nga institucioni si Edupage dhe Microsoft Teams, syllabuset e secilës lëndë, kurrikula e programit të studimit dhe materialet mbi leksionet dhe seminarët gjatë periudhës së mësimdhënies online. Kjo praktikë informimi vazhdon të zbatohet edhe në kushtet e mësimdhënies me prani fizike, në platformat që institucioni ka në përdorim.</p> <p>(Shtojca nr. 72 : Vendim Nr.10 : Politika e arsimit në distancë ; Shtojca nr.73 : Udhëzim 12 për vijimin dhe mbylljen e vitit akademik 2019-2022 ; Shtojca nr.74 : Vendim për vijimin dhe mbylljen e vitit akademik 2019-2022, Shtojca nr. 98 : Njihu me Kolegjin Universitar LOGOS; Shtojca nr. 96 : Aktivitetet e Fakultetit Ekonomik të KU "Logos" për vitet akademike 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Një rol të rëndësishëm si pjesë përbërëse e strukturës së Kolegjit Universitar LOGOS luan Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës. Ajo vendos në qendër të vëmendjes stimulimin e talenteve individuale të studentëve dhe integrimin sa më të shpejtë në tregun e punës në harmoni me disiplinën e studimeve të tyre, kjo në bashkëpunim të ngushtë me institucionet dhe shoqëritë që KU LOGOS ka marrëveshje bilaterale dhe me pedagogët udhëheqës së praktikave profesionale. Kjo zyrë rezultoi një nga hallkat kryesore të lidhjes së institucionit me nevojat e tregut të punës dhe atë të investimeve. Gjithashtu, rezultoi se, Kolegji Universitar "Logos" ka formuar rrjetin e studentëve të diplomuar (Logos-Alumni) i cili përbëhet nga studentë të diplomuar në Ciklin e Parë Bachelor dhe në Ciklin e Dytë Master. Studentët pjesë e rrjetit LOGOS-ALUMNI rezultojnë, bashkëpunëtorët kryesorë të Kolegjit Universitar "Logos", mbledhësit e fondeve për projektet, ideatorët e programeve të reja, kontribuesit në krijimin e tregjeve të punës për studentët, dhe promovuesit më të mirë të KU LOGOS në vazhdimësi.</p>

	<p>(Shtojca nr.37: Marrëveshjet e bashkëpunimit me bizneset; Shtojca nr. 89: Mjetet e komunikimit me studentët, Shtojca nr.76. Dokumentat për praktikën profesionale për studentët e programit të studimit Master Profesional në “Financë-Kontabilitet”, Shtojca nr.102: Të dhëna mbi ALUMNI në programin e studimit Master Profesional në Financë Kontabilitet. Statistika punësimi analizë; Shtojca nr 96. Aktivitetet e Fakultetit Ekonomik të KU “Logos” për vitet akademike 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022, faqe 13).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konstatoi se, studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet adresës së e-mailit dhe faqes zyrtare të web, lidhur me çdo ndryshim që ndikon në procesin mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit sa më eficient të tij (ndryshimet lidhur me orarin e mësimit apo zëvendësimit, përditësime të tyre, orarin dhe sallat e provimeve, orarin e konsultimeve etj.) Gjithashtu rezultoi se gjatë kohës së pandemisë për t’i ardhur në ndihmë studentëve u hap në faqen web një rubrikë e veçantë “LOGOS ONLINE” e cila i informonte ata në kohë reale, lidhur me gjithë procesin mësimor dhe çdo aktivitet. Nëpërmjet platformës Microsoft TEAMS dhe Edupage, lektori i lëndës zhvillon një strukturë të veçantë komunikimi nëpërmjet krijimit të klasave sipas lëndëve përkatëse dhe komunikimit për detyrat e tyre, vlerësimin sipas syllabusit të lëndës, temat që duhen studiuar, literaturën bazë dhe atë të rekomanduar, materiale shtesë dhe mënyrën e vlerësimit të tyre, metodën e përgatitjes, zhvillimit dhe vlerësimit të detyrave të kursit.</p> <p>(Shtojca nr.72: Vendim Nr.10 Politika e arsimit në distancë; Shtojca nr; Shtojca nr.73: Udhëzim 12 për vijimin dhe mbylljen e vitit akademik 2019-2022; Shtojca nr.74: Vendim për vijimin dhe mbylljen e vitit akademik 2019-2022, Shtojca nr.65: Udhëzues në nivel institucional, metoda inovative të mësimdhënies)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Bazuar në takimin me studentët, GVJ konstatoi se secili student pajiset me kredencialet dhe mund të aksesojë në klasat virtuale të platformës Microsoft TEAMS dhe EduPage, ku disponohet informacioni mbi programin e studimit, organizohen përpunohen dhe transmetohen të dhënat që kanë të bëjnë me veprimtarinë akademike që nga regjistrimi i studentëve deri në diplomimin e tyre.</p> <p>(Shtojca 72 nr.: Vendim Nr.10 Politika e arsimit në distancë ; Shtojca nr.73: Udhëzim nr.12 Për vijimin dhe mbylljen e vitit akademik 2019-2022; Shtojca nr.74 Vendim për vijimin dhe</p>


	<i>mbylljen e vitit akademik 2019-2020, Shtojca nr.65: Udhëzues në nivel institucional, metoda inovative të mësimdhënies).</i>			
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës organizon në mënyrë të vazhdueshme, nëpërmjet një kalendari aktiviteteve të miratuar çdo fillim viti akademik, leksione të hapura, workshop-e, seminare informuese.</li> <li>- Mjete të rëndësishëm informimi në kohë reale rezultojnë faqja zyrtare e Kolegjit Universitar "LOGOS", platforma EDUPAGE dhe Microsoft TEAMS, rrjetet sociale apo adresat e emaile-t.</li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Bazuar në vizitën në sekretarinë mësimore, GVJ evidentoi se Kolegji Universitar "LOGOS", disponon të dhëna statistikore vjetore të cilat përpilohen në fillim dhe përfundim të çdo viti akademik për programin mësimor Master Profesional në Financë Kontabilitet dhe i përcillen MASR. Këto të dhëna ruhen elektronikisht dhe në hard copy në zyrën e sekretarisë mësimore. Në këto të dhëna pasqyrohet numri i studentëve që kanë aplikuar, numri i atyre që janë regjistruar dhe numri i studentëve të diplomuar.</p> <p>(Shtojca nr.12: Rregullore Arkiv – Protokolli, Shtojca nr. 85: Tabelë përmbledhëse me numrin e studentëve të regjistruar 2019-2022). ).</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para	<p>Sipas (Shtojca nr. 2 : Rregullore e përgjithshme e KU "LOGOS", Neni 51, pika 1,2,23; Shtojca nr. 9: Rregullore e Sekretarisë Mësimore; Shtojca nr.77: Vendim Dekanati FE Për ngritjen e Komisionit për transferimet; Shtojca nr. 79. Udhëzim për transferimet), Sekretaria mësimore, në fillim të çdo viti akademik në Kolegjin Universitar "LOGOS, përgatit listat e studentëve, për programin Master Profesional në "Financë Kontabilitet",</p>

<p>përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>përkatësisht të atyre të regjistruar për herë të parë, atyre që transferojnë studimet, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit apo mos përfundimit me sukses të vitit akademik. Rezulton se, Bazuar në rregulloren e Institucionit si dhe në Udhëzimin e MASR Nr.16, datë 08.07.2019, sekretaria mësimore, mban të dhënat e Regjistrit Themeltar në format elektronik dhe të shkruar me dorë. Gjithashtu, në këto regjistra pasqyrohen edhe largimet/çregjistrimet përpara përfundimit të studimeve. Këto të dhëna mund t'i komunikohen Përgjegjësit të Departamentit për nevoja të plotësimit të raportit vjetor të vetëvlerësimit të brendshëm, pasi i ka drejtuar kërkesën Kryesekretarit. Numri i studentëve të reregjistruar për tre vitet ishte</p> <p>2019-2020 18 studente 2020-2021 19 studente 2021-2022 13 studente.</p> <p>(Shtojca nr. 2 : Rregullore e përgjithshme e KU "LOGOS", Neni 51, pika a, Shtojca nr.85: Tabelë përmbledhëse me numrin e studentëve të regjistruar 2019-2022).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Pas vizitës në Institucion, GVJ konstaton se, sekretaria mësimore e Fakultetit Ekonomik të KU "LOGOS" disponon statistika vjetore për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas programeve të studimit dhe cikleve të studimit. Gjithashtu, ajo ruan të dhëna të detajuara, në lidhje me numrin e studentëve të secilit viti akademik, transferimet dhe çregjistrimet, ecurinë akademike të studentit, numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik, si dhe të dhënat e studentëve që diplomohen, përfshi edhe temën e diplomimit. (Shtojca Nr. 85. Tabelë përmbledhëse me numrin e studentëve të regjistruar 2019-2022). Sekretaria ruan dokumentacionin e domosdoshëm në versionin fizik , për çdo student të programit të studimit Master Profesional në Financë Kontabilitet, njëkohësisht dhe elektronikisht në sistemin e brendshëm të informacionit të KU "LOGOS".</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe</p>	<p>Nëpërmjet raporteve vjetore të programit mësimor në Master Profesional Financë Kontabilitet, Kolegji Universitar "LOGOS" vlerëson gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe dokumentacionit që lidhet me veprimtarinë e studentëve dhe menaxhimin e tyre. Gjithashtu , rezulton se, nëpërmjet raporteve të akreditimit institucional kryhet procesi i vlerësimit, monitorimit dhe saktësisë së dokumentacionit që lidhet me studentët, të mbajtur nga njësitet përgjegjëse për menaxhimin administrativ të tyre. Sekretaria mësimore e Fakultetit Ekonomik disponon statistika</p>

saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	vjetore për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik, tërheqjet nga programi mësimor në Master Profesional në Financë Kontabilitet, si dhe largimet para përfundimit të programit, notën mesatare hyrëse dhe dalëse.								
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit referuar Analizës Vjetore të Kolegjit Universitar “Logos” rezulton se, çdo vit akademik, Institucioni paraqet raportet vjetore për veprimtarinë e kryer nga njësiti bazë dhe kryesore, pranë MASR-së. Ndërmjet të tjerash, në raport paraqiten statistika të cilësisë në hyrje dhe dalje të studentëve dhe shkalla e punësimit të tyre në programin e studimit Master Profesional në Financë Kontabilitet dhe programeve të tjera të ofruara. GVJ evidentoit se, Departamenti Financë Kontabilitet në bashkëpunim me Zyrën e Çështjeve Studentore ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione shtetërore dhe shoqëri private, në funksion të praktikave profesionale dhe integritit të studentëve në punë. Në raportet e tij vjetore, u vu re se Departamenti Financë Kontabilitet analizon cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve (Shtojca nr 23. Raporti Vjetor i Departamentit Financë-Kontabilitet për vitet akademike: 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022). (Shtojca nr. 32: Studimi i tregut 2021).								
<b>Konkluzione</b>	GVJ konstaton se: - KU “Logos” mban statistika të rregullta vjetore në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar, të diplomuar, si dhe të dhëna rreth cilësisë në hyrje dhe dalje të tyre. Analiza e punësimit të studentëve pas diplomimit bëhet në mënyrë periodike nga Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, analizë e cila i vendoset në dispozicion Departamentit Financë-Kontabilitetit, me qëllim hartimin e raporteve periodike.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**



#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

**Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se, KU “Logos” garanton përfshirjen e studentëve në vendimmarrje, këshillim apo vlerësim mbi procesin akademik në organet kolegjinale të tij, bazuar

<p>dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>kjo në Rregulloren e përgjithshme të Kolegjit Universitar “LOGOS” dhe Statutin e tij. Studentët kanë të drejtë të kenë përfaqësues në senatin akademik me dy anëtarë studentë duke respektuar kuotat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, bazuar në Rregulloren e përgjithshme të Kolegjit Universitar “LOGOS” (Shtojca nr.5, neni 25, neni 26). Gjithashtu studentët përfaqësohen me njërin prej tyre dhe në grupin e vlerësimit të brendshëm për akreditimin e programit mësimor Master Profesional në Financë Kontabilitet, në Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë NJSBC, në Komisionin e përhershëm të marrëdhënieve me studentët dhe Komisionin e Përhershëm të Garantimit të Cilësisë KPGSC dhe në Këshillin studentor Këshillin e Etikës.</p> <p><i>(Shtojca nr 17. Përbërja e Senatit Akademik. Vendimi nr.23, datë 30.10.2020, Shtojca nr.100: Statuti i Këshillit Studentor; Shtojca nr.10_: Rregullore e Këshillit Studentor; Shtojca nr 99: Organizimi i zgjedhjeve të Këshillit Studentor 2020, Shtojca nr. ___: 81. Përbërja e Këshillit të Etikës, Vendimi Nr 3, datë 12.10.2021, Shtojca nr. 109. Përbërja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni, Shtojca nr 110. Përbërja e Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Sigurimit të Cilësisë).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Bazuar në Statutin e KU “LOGOS” dhe Rregulloren e Këshillit Studentor, vihet re se Kolegji Universitar “LOGOS” mbështet organizmat studentorë të krijuar nga zgjedhjet e organizuara nga vetë studentët, të monitoruar dhe mbështetur nga Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës. Gjithashtu, Kolegji Universitar “LOGOS”, i trajton me prioritet kërkesat për realizimin e aktiviteteve të ndryshme ekstrakurrikulare apo kërkesat të cilat vijnë nga ata për përmirësimin e shërbimit. Gjithashtu veprimtari të rëndësishme të veçantë për studentët të iniciuara nga ata e të propozuara nga këshillat janë të tilla: blerje librash, aktivitete jashtëshkollore, organizime në vizita në kompani sipas profilit të programit të studimeve, organizime në evente të panairit të punës, panairit të librit, etj.</p> <p><i>(Shtojca nr. 99. Organizimi i zgjedhjeve të Këshillit Studentor në vitet 2019-2022, Shtojca nr 101. Financimi i veprimtarive të propozuara nga Këshilli Studentor).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe</p>	<p>GVJ konstatoi se Kolegji Universitar LOGOS dhe departamenti Financë Kontabilitet, nëpërmjet ngritjes së instrumentave matës për vlerësimin e mësimdhënies, mësimnxënies apo përmirësimit të programeve të studimit, angazhohen të përfshijnë studentët në</p>

<p>përmirësimin e programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>vlerësimin e procesit akademik. Nëpërmjet pyetësorëve të plotësuar nga çdo student, mblidhen vlerësime, e sugjerime të cilat kontribuojnë në përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies reflektuar kjo në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programit të studimit duke e bërë sa më koherent me tregun e punës në vend. Studentët janë pjesë e vendimmarrjes në struktura të ndryshme, gjë që vërteton mbështetjen nga Institucioni për përfshirjen e tyre në këshillim. (Shtojca nr 111. Raporti vjetor NJSBC: 2020-2021; 2021-2022, Shtojca nr 17. Përbërja e Senatit Akademik. Vendimi nr.23, datë 30.10.2020; Shtojca nr 81. Përbërja e Këshillit të Etikës, Vendimi Nr 3, datë 12.10.2021; Shtojca nr 99. Organizimi i zgjedhjeve të Këshillit Studentor në vitet 2019-2022, Shtojca nr. 110. Përbërja e Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Sigurimit të Cilësisë).</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se Departamenti Financë-Kontabilitet ka procedura të qarta në lidhje me vlerësimin, ankimimin dhe rishqyrtimin e vlerësimit të studentëve. Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit, bazuar kjo në Nenin 40 të Rregullores së Departamentit Financë Kontabilitet. Departamenti ngre edhe një komision ad-hoc i cili përbëhet nga Përgjegjësi i Departamentit, një anëtar pedagog i disiplinës përkatëse dhe pedagogu i lëndës për të verifikuar pretendimet e studentit dhe rivlerëson tezën e provimit. Vendimi i komisionit ad-hoc është përfundimtar.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Studentët përfaqësohen në organet kolegjiale brenda institucionit si: senati akademik, KPGSC, komisioni i përhershëm i marrëdhënieve me studentët, Këshilli i etikës, etj.</li> </ul>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

**Standardi V.6**

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**


<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
------------------------	--------------------------------------



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Bazuar në (Shtojca nr.2: Rregullore e përgjithshme e KU "LOGOS", Neni 130, 131), GVJ konstaton se Kolegji Universitar Logos, nëpërmjet zyrave përkatëse si Sekretaria Mësimore, Departamenti Financë Kontabilitet dhe Koordinatori për marrëdhëniet me studentët të programit mësimor dhe njoftimeve të vazhdueshme në rrjetet sociale, web, platformat online, adresa e-mail të studentëve, paraqet procedura të qarta për informimin e tyre. Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, si dhe koordinatori akademik pranë çdo departamenti, kryejnë aktivitetin e tyre në funksion të informimit, orientimit dhe këshillimit të karrierës për studentët.</p> <p>(Shtojca nr. 11: Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës; Shtojca nr.2: Rregullore e përgjithshme e KU "LOGOS", Neni 53; Shtojca nr. 44. Vendimi nr.25, datë 25.09.2021 i Dekanit FE për caktimin e Koordinatorëve sipas programit të studimit).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Studentët mund të informohen nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Kolegjit Universitar "Logos" për mënyrën e regjistrimit të tyre, orarin mësimor dhe orarin e provimeve, aktivitetet për studentin etj.</p> <p>Gjithashtu nëpërmjet një kalendari aktivitetesh të miratuar çdo fillimi viti akademik nga Fakultetet, organizohen në mënyrë të vazhdueshme nga Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, leksione të hapura, workshope, seminare informuese mbi procesin e edukimit financiar të cilat synojnë orientimin e studentëve mbi mënyrën e aplikimeve për vendin e punës, mënyrën e realizimit të një letre motivimi dhe të CV-ve, mënyrën e realizimit të suksesshëm të një interviste etj. GVJ konstatoi se koordinatori akademik bën një plan për hartimin e të ardhmes akademike të studentëve pas diplomimit, duke konfirmuar ekzistencën e një monitorimi të vazhdueshëm të progresit akademik të tyre.</p> <p>(Shtojca nr 96. Aktivitetet e Fakultetit Ekonomik të KU "Logos" për vitet akademike 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se Kolegji Universitar LOGOS, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe kompani të ndryshme, të cilat ju japin mundësinë studentëve të programit të studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet", të kryejnë praktikat profesionale dhe pse jo në përfundim të saj, të punësohen. Po kështu, Zyra e Karrierës dhe e Çështjeve studentore të Kolegjit Universitar LOGOS, ka si</p>




<p>informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>mision një përfaqje më të mirë të studentëve me tregun e punës, duke i mbështetur dhe inkurajuar në zhvillimin e plotë të potencialit të tyre, për një performancë më të mirë dhe integrimin sa më të shpejtë në treg.</p> <p>Rezulton se me pjesëmarrjen e Dekanëve, Përgjegjësve të Departamenteve, stafit akademik dhe administrativ dhe përfaqësuesin e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, Kolegji Universitar “LOGOS” organizon takime informuese me studentët që përfundojnë nivelin Bachelor për t’i orientuar për mundësitë e tyre për studime në ciklin Master Profesional. (Shtojca nr. 92: Orientimi dhe Këshillimi i studentëve tanë për kalimin në Ciklin e Dytë të studimeve, Shtojca nr 37. Marrëveshje bashkëpunimi KU “Logos” me bizneset).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton se, Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të karrierës në bashkëpunim me Fakultetin Ekonomik, konkretisht me Departamentin Financë Kontabilitet, mban komunikim të vazhdueshëm me kompanitë për integrimin e studentëve në tregun e punës, që nga realizimi i praktikave deri në punësimin e plotë ose të pjesshëm të tyre.</p> <p>Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës pranë Kolegjit Universitar “LOGOS” disponon të dhëna statistikore mbi punësimin e të diplomuarve.</p> <p>Gjithashtu, rezulton se në bashkëpunim me Fakultetet në strukturën e tij akademike, Kolegji Universitar “LOGOS”, ka ftuar vazhdimisht studentët të bëhen pjesë e Panairëve të Punës duke i dhënë mundësi atyre të njihen me punëdhënës potencialë, të kryejnë intervista të drejtpërdrejta në stenda të punëdhënësve si dhe të orientohen në lidhje me kërkesat në tregun e punës.</p> <p>(Shtojca nr.104. Formular i Vlerësimit nga punëdhënësi për ish-studentin ALUMNI, Shtojca nr.105: Zyra Erasmus +; Shtojca nr 96. Aktivitetet e Fakultetit Ekonomik të KU “Logos” për vitet akademike 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022, faqe 20-24; Shtojca nr 37. Marrëveshje bashkëpunimi KU “Logos” me bizneset, Shtojca nr 38. Marrëveshje bashkëpunimi KU “Logos” me institucione joarsimore, Shtojca nr.95: Pjesëmarrja në Panairët e Punës)</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, si dhe koordinatori akademik, kryejnë aktivitetin e tyre në funksion të informimit, orientimit dhe këshillimit të karrierës për studentët.</li> </ul>




	<i>KU "Logos" ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe kompani të ndryshme, të cilat ju japin mundësinë studentëve të programit të studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet" të kryejnë praktikat profesionale.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


<b>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues, si dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në Kolegjin Universitar "Logos", GVJ konstatoi angazhimin e institucionit për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Kolegji Universitar "Logos" ka hartuar udhëzues për Mënyrën e Zhvillimit të Mësimin, Laboratorëve, Praktikave dhe Provimeve, Udhëzues për Mësimin në Distançë për Studentët, si dhe janë kryer trajnime për përdorimin e platformave Microsoft Office 365 dhe Edupage.</p> <p>Udhëzuesit janë të dokumentuar në gjuhën shqipe dhe angleze dhe janë vendosur në faqen web të institucionit. (Link: <a href="http://www.kulogos.edu.al/al/distance-learning.html">http://www.kulogos.edu.al/al/distance-learning.html</a>)</p> <p>Nga vizita në institucion, u konstatua që për studentët e këtij program studimi vihen në dispozicion laboratorë me programe statistikore si R-Studio apo SPSS për të përpunuar të dhënat dhe për të realizuar kërkimin shkencor. Megjithatë nga vizita në institucion u konstatua se lëndët që zhvillohen nuk parashikojnë orë laboratorike.</p> <p><i>Shtojca nr. 65: Udhëzues në nivel institucional, metoda inovative të mësimdhënies; Shtojca nr. 66: Manuali i mësimdhënies online, Shtojca nr. 63: Manual i përdorimit të Platformës Edupage.</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>GVJ konstatoi se monitorimi dhe vlerësimi periodik i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet nga njësia e posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit, në bashkërendim me njësinë bazë dhe atë kryesore.</p> <p>Këtë aktivitet Kolegji Universitar “LOGOS” e zhvillon bazuar në Statutin e tij dhe Rregulloren e Përgjithshme, Politikën e Sigurimit të Cilësisë të KU “Logos” dhe Rregullores Për Sigurimin e Cilësisë. Mbi bazën e këtyre dokumentave bazohet hartimi i udhëzuesve të posaçëm për vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në çdo fund semestri para fillimit të sezonit të provimeve, dy herë në vit, bëhet vlerësimi për aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p> <p><i>Shtojca nr. 1: Statuti i Kolegjit Universitar “Logos”, Shtojca nr. 2: Rregullore e Përgjithshme e Kolegjit Universitar “Logos”; Shtojcat nr. 108; Shtojca nr. 6.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, nëpërmjet kryerjes së pyetësorëve, garanton nga ana institucionale, përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, e të vlerësimit të dijeve. Pyetësorët plotësohen online nga studentët, nëpërmjet Platformës Microsoft Teams, në çdo fund semestri para fillimit të sezonit të provimeve. Rezultatet trajtohen dhe firmosen nga anëtarët e NJSBC-së dhe i komunikohen dhe raportohen Rektorit të KU “Logos”. Vlen të theksohet se studentët kanë një përfaqësues të tyre si pjesë e anëtarësisë së NJSBC-së dhe KPGSC-së.</p> <p>Vihet re se dhe njësitë bazë kryejnë analiza të vazhdueshme, nëpërmjet pyetësorëve të drejtuar studentëve në fund të një cikli studimesh, për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit që ofrojnë, nëpërmjet pyetësorëve drejtuar bashkëpunëtorëve në tregun e punës, vlerësimin e institucioneve ku studentët kryejnë praktikat profesionale, si dhe gjatë mbledhjeve periodike ku diskutohen nevojat për përmirësim, të identifikuara gjatë semestrit.</p> <p><i>Shtojca nr. 109: Përbërja e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni; Shtojca nr. 110: Përbërja e Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Sigurimit të Cilësisë, Shtojcë nr. 117: Pyetësori i departamenti drejtuar studentëve për përmirësimin e programit të studimit, Shtojcë nr 76: Dokumentat</i></p>




	<p><i>për praktikën profesionale për studentët e programit të studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet"</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përveçse kryen vlerësime periodike për matjen e cilësisë së programit të studimit, harton dhe Raport Semestral dhe Raport Vjetor. Gjithashtu, NJSBC-ja kujdeset që KPGSC të sigurojë publikimin e tyre. Po kështu dhe Komisioni i Përhershëm i Garantimit të Sigurimit të Cilësisë përpilon raporte periodike mbi analizën e gjetjeve, bazuar kjo në Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë.</p> <p>Fakulteti Ekonomik përgatit raportin e tij vjetor, rezultatet e të cilit bëhen pjesë e Raportit Institucional. Rektorati, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, miratojnë Raportin Institucional me vendimet përkatëse dhe më pas ky i fundit paraqitet në Minsitrinë e Arsimit në përmbushje të detyrimeve të KU Logos.</p> <p><i>Shtojca nr. 21: Raporti Vjetor Institucional për vitet akademike: 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022, Shtojca nr. 111: Raporti vjetor NJSBC: 2020-2021; 2021-2022, Shtojca nr. 22: Raporti Vjetor i Fakultetit Ekonomik për vitet akademike: 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstaton se, në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies në programet e studimit të ofruara nga njësitë përkatëse, Senati akademik në bazë të analizimit të gjetjeve nga raportimet e kryera nga NJSBC dhe KPGSC, merr në konsideratë kryerjen e propozimeve në formën e rekomandimeve drejtuar njërive kryesore. Vlen të përmendet se nga analizimi i raportimeve, janë propozuar tematika për mbështetje trajnuese të stafit akademik dhe në bazë të tyre është hartuar plani i trajnimit të stafit.</p> <p>Nga vizita në institucion GVJ evidentoi se rezultatet e vlerësimeve transformohen në masa konkrete operative për përmirësimin e programeve të studimit të ofruara. Bazuar në Rregulloren e Përgjithshme të KU Logos dhe planin mësimor, rezultojnë se janë diskutuar, zbatuar dhe bërë publike praktikave më të mira, në njësinë bazë dhe atë kryesore, në qëllim të të cilave janë organizuar edhe takime me studentët, në mënyrë që ata të kuptojnë rolin dhe vlerën e këtyre praktikave</p> <p><i>Shtojca nr. 88: Leksione të Hapura KU "Logos" 2019-2022; Shtojca nr. 96: Aktivitetet e Fakultetit Ekonomik të KU "Logos" për vitet akademike 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022).</i></p>




<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në Kolegjin Universitar “LOGOS”, GVJ konstatoi se Kolegji Universitar “LOGOS”, ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë, siç është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni dhe Komisioni i Përhershëm për Garantimin të Sigurimit të Cilësisë, veprimtaria e të cilave mbështetet në Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë.</p> <p>Gjithashtu, siç udhëzon pika 5 e nenit 103 të Ligjit nr 80/2015, Institucioni ka hartuar politika për sigurimin e brendshëm të cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë. Komisioni i Sigurimit të Cilësisë harton dokumentin e politikës për sigurimin e cilësisë, i cili miratohet nga Senati Akademik.</p> <p><i>Shtojca nr. 109: Përbërja e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni, Shtojca nr. 110: Përbërja e Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Sigurimit të Cilësisë, Shtojcë nr. 6: Rregullore për sigurimin e cilësisë, Shtojcë nr 108. Politika për sigurimin e cilësisë</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen	<p>Dokumentacioni i shqyrtuar vërteton se Kolegji Universitar “LOGOS” ka ngritur dhe ka vënë të funksionojë Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, për të identifikuar përgjegjësitë funksionale të organeve dhe autoriteteve përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet.</p> <p>Për të garantuar që, veprimtaria e Kolegjit Universitar “LOGOS” i plotëson standardet shtetërore të cilësisë, funksionojnë Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm i Garantimit të Sigurimit të Cilësisë.</p>

<p>studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>GVJ konstatoi se Insitucioni bashkëpunon me një ekspert të jashtëm, i cili është anëtar në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>Sistemi i sigurimit të cilësisë bën ndjekjen, vlerësimin, monitorimin e procesit të mësimdhënies. Gjithashtu në bashkëpunim me njësinë kryesore/bazë, realizon koordinimin e bashkërendimin e aktiviteteve për arritjen e një cilësie të lartë të veprimtarisë akademike, kërkimore dhe shërbyese të Kolegjit Universitar “LOGOS”. Trupa studentore është pjesë e anëtarësisë në të dyja strukturat dhe ka një rol aktiv në proceset e cilësisë.</p> <p><i>Shtojcë nr . 15: Plani strategjik i Kolegjit Universitar “Logos”, 2018-2024, Shtojca nr. 109: Përbërja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni; Shtojca nr. 110: Përbërja e Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Sigurimit të Cilësisë, Tabela 24 – Përbërja e NJSBC-së &amp; KPGSC</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se mjetet nëpërmjet të cilave sigurohet cilësia në KU “Logos” janë menaxhimi i cilësisë, rritja e cilësisë, kontrolli i cilësisë dhe vlerësimi i cilësisë. Procesi i vazhdueshëm i monitorimit, vlerësimit, garantimit dhe përmirësimit të cilësisë së Institucionit e programeve që ai ofron, duke u bazuar në kriteret e brendshme e të jashtme, udhëhiqet nga politika për sigurimin e cilësisë në Kolegjin Universitar “LOGOS”.</p> <p>Rezulton se, në Kolegjin Universitar “LOGOS” sigurimi i cilësisë realizohet nëpërmjet procesit të sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë.</p> <p>Paketa e instrumenteve për sigurimin e cilësisë përgatitet e përditësohet nga Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë në Kolegjin Universitar “LOGOS” në zbatim të politikës për sigurimin e cilësisë ku vlen të përmenden:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- vlerësimi i brendshëm në nivelin e institucionit, të njëjësive kryesore, të njësisë bazë;</li> <li>- vlerësimi i brendshëm për programet e studimit dhe mësimdhënien;</li> </ul> <p>Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë në KU “LOGOS” kryen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- vlerësimin e veprimtarive kërkimore-shkencore;</li> <li>- vlerësimin e cilësisë së arritjeve të studentëve;</li> <li>- vlerësimin e ccurisë së punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga KU “Logos” në bashkëpunim gjithashtu me Zyrën e Koordinimit të Çështjeve Studentore.</li> </ul>





	<p>GVJ konstaton se Kolegji Universitar “LOGOS”, në bazë të raporteve të monitorimit dhe të vlerësimit, në funksion të sigurimit të cilësisë, realizon përmirësimet e kërkuara. NJSBC kujdeset për gjykimin e gjetjeve nga rezultatet e anketimeve, si dhe harton përmirësime të nevojshme në planin mësimor apo rishikimin e syllabuseve.</p> <p><i>Shtojcë nr. 108: Politika për sigurimin e cilësisë, Shtojca nr. 111: Raporti vjetor NJSBC: 2020-2021; 2021-2022; Shtojca nr. 21: Raporti Vjetor Institucional për vitet akademike: 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022; Shtojca nr. 22: Raporti Vjetor i Fakultetit Ekonomik për vitet akademike: 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022; Shtojca nr. 23: Raporti Vjetor i Departamentit Financë-Kontabilitet për vitet akademike: 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022; Shtojcë nr. 27: Procesverbal për përditësimin e miratimit të syllabuseve, Shtojcë nr. 113: Paketa e instrumenteve të NJSBC</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësi, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>GVJ vlerëson se, në përputhje me Kodin e Cilësisë, Standardet Europiane të Arsimit të Lartë, standardet ISO 9001: 2015, Kolegji Universitar “LOGOS” evidenton si objektiv të qartë në planin e tij strategjik, domosdoshmërinë e përbushjes së të gjitha standardeve të cilësisë, përmes proceseve të sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit.</p> <p>Kështu, rezulton se, Kolegji Universitar “LOGOS” ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit që ofron, me qëllim krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, në bazë të rregullores për sigurimin e cilësisë.</p> <p>GVJ konstaton se, Kolegji Universitar “LOGOS” ka ndërtuar veprimtarinë e tij për sigurimin e cilësisë bazuar në dy qasje:</p> <p>a) në qasjen "cilësia si përputhje me misionin, qëllimin", e cila nënkupton cilësinë si përbushje të misionit të institucionit dhe të qëllimit të një programi studimi, të objektivave të vendosura, të një rezultati të pritshëm;</p> <p>b) në qasjen e "bazuar në standarde", e cila e nënkupton cilësinë si përbushje të standardeve shtetërore të cilësisë që lejojnë një shkallë të krahasimit.</p> <p><i>Shtojca nr. 108: Politika për sigurimin e cilësisë, Shtojcë nr. 6: Rregullore për sigurimin e cilësisë,</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kolegji Universitar “LOGOS” ka ngritur struktura dhe ndjek procedura të qarta për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</li> </ul>




	<ul style="list-style-type: none"> <li>- KU "LOGOS" ka ngritur dhe ka vënë të funksionojë Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, për të identifikuar përgjegjësitë funksionale të organeve dhe autoriteteve përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet.</li> <li>- Institucioni angazhohet për një kulturë cilësore në tërësinë e tij, duke e bërë sigurimin e cilësisë përgjegjësi të të gjithëve dhe vlerësimin një pjesë integrale të aktivitetit të tij.</li> </ul> <p>Trupa studentore është pjesë e anëtarësisë së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisionit të Përhershëm i Garantimit të Sigurimit të Cilësisë.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në Kolegjin Universitar "LOGOS", GVJ konstatoi se Kolegji Universitar "LOGOS", për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve, siguron mekanizma e procese formale e të dokumentuara, nëpërmjet planeve të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të standardeve shtetërore të cilësisë për Institucionin dhe programet që ai ofron, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Raportet periodike të cilësisë të hartuara nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Sigurimit të Cilësisë</li> <li>- Shqyrtimi i raporteve të vlerësimeve të jashtme dhe analizimi i plotësisht të rekomandimeve të lëna nga Bordi i Akreditimit, gjatë proceseve të akreditimeve periodike të mëparshme të programeve të studimit, si pjesë e vlerësimit të jashtëm të cilësisë;</li> <li>- Monitorimet e kryera nga njësitë bazë dhe kryesore të pasqyruara edhe në raportet vjetore të tyre.</li> </ul> <p>Nga takimi me NJSBC-në GVJ vlerëson se procesi për komunikimin dhe publikimin e vlerësimit mbikëqyret nga NJSBC-</p>

<p>vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>ja. Për këtë proces kjo e fundit harton një raport, i cili i dërgohet Rektorit të Kolegjit Universitar “Logos”, i cili raporton në Senat. Në vijim raporti i dërgohet drejtuesve të njësive kryesore, të cilët e përcjellin tek drejtuesit e njësive bazë.</p> <p>Vihet re se rezultatet e raportit të NJSBC-së i komunikohen personelit akademik të departamentit, si dhe vlerësimet individuale për secilin prej tyre, nga Drejtuesit e njësive bazë. Në lidhje me gjetjet e NJSBC-së, Departamenti gjykon se çfarë duhet të konsiderohet dhe harton kalendarin dhe planin e përmirësimeve të synuara, si dhe cakton personat përgjegjës për realizimin e tyre. Ky plan dërgohet për miratim në Senat. Departamenti njofton Rektorin për ecurinë dhe realizimin e gjetjeve dhe e mban të informuar NJSBC-në se ku kanë arritur përmirësimet e nevojshme.</p> <p>Nga shqyrtimi i Raporteve të NJSBC vërejmë se nuk kanë dale problematika lidhur me vlerësimet e studenteve nëpërmjet pyetësorëve.</p> <p>Po kështu, GVJ konstatoi se departamentet propozojnë ndryshime deri në masën 20% në funksion të përmirësimit të programit të studimit brenda periudhës kohore të akreditimit të radhës, sipas legjislacionit në fuqi, në funksion të monitorimeve për matjen e cilësisë së programeve të studimit të ofruara.</p> <p><i>Shtojca nr. 111: Raporti vjetor NJSBC: 2020-2021; 2021-2022, Shtojca nr. 117: Pyetësi i departamentit drejtuar studentëve për përmirësimin e programit të studimit; Shtojca nr. 23: Raporti Vjetor i Departamentit Financë-Kontabilitet për vitet akademike: 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022,</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>GVJ konstatoi se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë krijon, pasuron dhe mirëmban sistemin e përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave të monitorimit dhe të vlerësimit të brendshëm. Në bazë të rezultateve të monitorimeve të kryera, përgatiten raportet të cilat u komunikohen organeve, strukturave dhe autoriteteve përkatëse të Kolegjit Universitar “LOGOS”. Të dhënat e monitorimeve dhe vlerësimeve të kryera përdoren për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit.</p> <p>Rezulton se, raportet e NJSBC-së evidentojnë krahasimet e rezultateve semestrale dhe vjetore për cilësinë e mësimdhënies, evidentojnë sugjerimet objektive të studentëve, adresojnë mangësitë e evidentuara dhe sugjerojnë masat e nevojshme që duhet të merren në funksion të përmirësimit të cilësisë.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ vlerëson se KU “Logos” mbështet stafin për</p>

	<p>rritjen e formimit të tyre akademik e shkencor, trajnon stafin akademik për metodat e mesimdhënies nga ekspertë të huaj e profesorë të Universiteteve partnere dhe ka rritur numrin e mobiliteteve të stafit akademik me universitet partnere në kuadër të programit Erasmus+. Në dosjen e personelit akademik efektiv të shqyrtuar nga GVJ, u vu re mbështetja financiare e institucionit në kuadër të studimeve të doktoratës.</p> <p><i>Shtojca nr. 112: Trajnime të stafit akademik organizuar për sigurinë e cilësisë në mesimdhënie; Shtojca nr. 115: Mbështetja e institucionit për stafin akademik; Shtojca nr. 31: Mobilitete të stafit akademik në kuadër të Erasmus +, Shtojca nr. 111: Raporti vjetor NJSBC: 2020-2021; 2021-2022; Shtojcë nr. 114: Procedura e administrimit të vlerësimit të cilësisë së mesimdhënies nga NJSBC</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mesimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ në takimin me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë konstatoi se ajo organizon e monitoron në fund të çdo semestri, para fillimit të sezonit të provimeve, procesin e vlerësimit të cilësisë së mesimdhënies nga studentët dhe në fund të vitit akademik vlerësimin e veprimtarisë së departamentit.</p> <p>Po kështu, Kolegji Universitar “LOGOS”, përdor metoda të drejtpërdrejta në mënyrë që të vlerësojë realizimin, mbarëvajtjen dhe cilësinë e programit të studimit, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- plotësimi i formularëve të vlerësimit nga studentët në fund të çdo semestri para sezonit të provimeve, me qëllim vlerësimin e cilësisë së mesimdhënies</li> <li>- vlerësimi i didaktikës, i kurrikulës, nëpërmjet përditësimit të kurrikulave ekzistuese me qëllim zhvillimin e tyre bazuar në kompetenca dhe në kërkime, me në qendër studentin;</li> <li>-përprjekja për hapjen e programeve të reja të studimit në përputhje me nevojat e tregut etj. Rezulton se, Kolegji Universitar “LOGOS”, e ka parashtruar në strategjinë e tij të zhvillimit objektivin prioritar të hartimit të instrumenteve të vlerësimit të kurrikulës.</li> <li>- sipas rastit nëse ka kontestime nga ana e studentëve, bëhen vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, megjithëse kriteret e vlerësimit janë transparente dhe të qarta;</li> </ul> <p><i>Shtojca nr. 113: Paketa e instrumenteve të NJSBC-së; Shtojca nr. 116: Pyetësor për vlerësimin e cilësisë së mesimdhënies nga studentët, Shtojcë nr. 15: Plani strategjik i zhvillimit të KU “Logos”, 2018-2024, prioriteti strategjik 2, fq 17</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e</p>	<p>Po kështu, GVJ konstatoi se, Kolegji Universitar “LOGOS”, përdor instrumente të tërthorta, në mënyrë që të vlerësojë realizimin, mbarëvajtjen dhe cilësinë e programit të studimit, si:</p>




<p>cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>-pyetësorë të studentëve në fund të një cikli studimi të hartuar nga njësia bazë me qëllim përmirësimin e kurrikulës së ofruar;          -pyetësorë të studentëve të diplomuar, anëtarë të LOGOS Alumni, aktivë në tregun e punës;          -raporte të vlerësimin të jashtëm të ekspertëve të fushës gjatë proceseve të akreditimeve të mëparshme të programit;          -pyetësorë për institucione publike dhe private me të cilat Institucioni bashkëpunon për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve.  <i>Shtojca nr. 117: Pyetësori i departamentit drejtuar studentëve për përmirësimin e programit të studimit, Shtojca nr. 103: Formulari ALUMNI, Shtojca nr. 104: Formulari i Vlerësimin nga punëdhënësi për ish-studentin ALUMNI</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ evidenton se strukturat e ngritura në institucion për cilësinë e mësimdhënies realizojnë vlerësimin e këtij procesi në mënyrë periodike si dhe përdor metoda të drjperdrejta dhe të tërthorta në këtë proces.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

**Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ vlerësoi se, Kolegji Universitar “LOGOS”, garanton dhe përmirëson cilësinë e programeve të studimit në vazhdimësi, ku mund të permenden:            1) përdorimi i Standardeve Shtetërore të Cilësisë të përcaktuara në Kodin e Cilësisë miratuar me VKM Nr. 531, datë 11.09.2018 (i përditësuar me VKM Nr.824, datë 24.12.2021) të publikuar nga ASCAL në vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit;            2) anëtarësimi i një eksperti të jashtëm në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;            3) monitorimi i procesit mësimor nga autoritetet drejtuese;</p>

	<p>4) anëtarësimi i studentëve në organet drejtuese të Kolegjit Universitar “LOGOS”, në analizat e punës dhe komisionet e ndryshme;</p> <p>5) marrja e mendimit të studentëve me qëllim përmirësimin e programeve të studimit;</p> <p>6) mbledhja e të dhënave në lidhje me punësimin e studentëve të diplomuar në programet e studimit që ofron institucioni.</p> <p><i>Shtojca nr. 116: Pyetësor për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nga studentët, Shtojca nr. 109: Përbërja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni; Shtojca nr. 110: Përbërja e Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Sigurimit të Cilësisë, Shtojca nr. 117: Pyetësori i departamentit drejtuar studentëve për përmirësimin e programit të studimit, Shtojca nr. 102: Të dhëna mbi ALUMNI në programin e studimit Master Profesional në Financë-Kontabilitet, Statistika punësimi analizë</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në Kolegjin Universitar “LOGOS”, GVJ konstatoi se institucioni ka përcaktuar qartë në rregulloren për sigurimin e cilësisë, përgjegjësitë dhe detyrat për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>Sipas nenit 8 të rregullores, cilësia në KU LOGOS, mbikqyret nga Senati Akademik i KU “LOGOS”, organi më i lartë drejtues akademik dhe Bordi i Administrimit i KU “LOGOS”, organi më i lartë kolegjal administrativ.</i></p> <p><i>Sipas nenit 16 të rregullores; Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është një strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ, ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit, ka autonomi operative dhe ka si detyrë të planifikojë, të drejtojë, të organizojë dhe të publikojë veprimtarinë e kryer në kuadrin e sigurimit të cilësisë në nivel institucioni dhe programesh studimi.</i></p> <p><i>Sipas nenit 9 të rregullores; Komisioni i Përhershëm i Garantimit të Sigurimit të Cilësisë, është organ kolegjal që vepron në nivel institucioni dhe ka përgjegjësinë për të garantuar se veprimtaria e KU “LOGOS” i plotëson standardet shtetërore të cilësisë .</i></p> <p><i>Sipas nenit 14 të rregullores; kushtet e duhura në Institucion në kuadrin e sigurimit të cilësisë dhe akreditimit, për realizimin e veprimtarive të monitorimit dhe të vlerësimit të brendshëm garantohen nga Rektori i KU “LOGOS”.</i></p> <p><i>Sipas nenit 15 të rregullores; Mbështetja financiare e nevojshme për të realizuar veprimtaritë e monitorimit dhe vlerësimit në kuadrin</i></p>




	<p>e sigurimit të cilësisë dhe akreditimit garantohej nga <i>Administratori i KU "LOGOS"</i>.</p> <p><i>Sipas nenit 17 të rregullores; sa herë ndërmerren veprimtari vlerësimi në nivel institucioni në KU "LOGOS", krijohet Grupi i Vlerësimit të Brendshëm të Institucionit. (organizëm ad-hoc).</i></p> <p><i>Këshilli studentor shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të institucionit, si dhe për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, cilësinë e shërbimeve. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Senat Akademik, në Komisionin e Garantimit të Standardeve të Cilësisë, në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe në Grupet e Vlerësimit të Brendshëm, gjë që garanton pjesëmarrjen e tyre në çështjet e cilësisë.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se në rregulloren për sigurimin e cilësisë rezultojnë përcaktohen qartë organizmat, autoritetet dhe strukturat përgjegjëse për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë të programeve të studimit që ato ofrojnë, në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë.</p> <p>Kështu rezultojnë se: Sipas nenit 19 të rregullores garantimi i kushteve të duhura për realizimin e veprimtarive të monitorimit dhe vlerësimit, në kuadër të sigurimit të cilësisë në njësinë kryesore dhe garantimi se rezultatet e vlerësimeve kthehen në masa operative konkrete për përmirësimet e duhura është përgjegjësi e Drejtuesit të Njësisë Kryesore.</p> <p>Sipas nenit 20 të rregullores; garantimi i kushteve të duhura për realizimin e veprimtarive të monitorimit dhe vlerësimit, në kuadër të sigurimit të cilësisë në njësinë kryesore dhe garantimi se rezultatet e vlerësimeve kthehen në masa operative konkrete për përmirësimet e duhura është përgjegjësi e Drejtuesit të Njësisë Bazë.</p> <p>Sipas nenit 21 të rregullores, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm i Njësisë Bazë, është një organizëm ad-hoc që krijohet sa herë ndërmerren veprimtari vlerësimi dhe ka si detyrë kryerjen e vlerësimeve të brendshme për njësinë bazë, sipas procedurave të parashikuara në Manualin e Cilësisë. Përgjegjësitë e atyre që marrin pjesë në vlerësim dhe vlerësohen, saktësohen në nenin 23 të Rregullores për Sigurimin e Cilësisë (<i>Shtojcë nr. 6, Kreu III, fq 15</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se, çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve shmanget nga përfshirja e aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit në Kolegjin Universitar "LOGOS". Për më tepër kjo gjë respekton integritetin</p>





<p>akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>akademik. Po kështu rezulton se, përfshirja e studentëve në proceset e vlerësimit, është gjithmonë e hapur, si iniciativë e vetë studentëve që dëshirojnë të angazhohen e të fitojnë eksperiencë në çështjet e cilësisë. Kryesisht, Kolegji Universitar “LOGOS” synon të përzgjedhë studentë të viteve të para të studimit, për angazhim në grupet e vlerësimit të brendshëm, me synim ndërgjegjësimin e tyre për rëndësinë e sigurimit të cilësisë në Institucion në përmbushje të standardeve të cilësisë.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>GVJ vlerëson se, Kolegji Universitar “LOGOS” ruan një bashkëpunim të shëndoshë me pedagogë të ftuar, kryesisht me përvojë të gjatë në arsim me tituj akademikë e grada shkencore dhe specialistë në fushat përkatëse, me një bashkëpunim ndër vite me Institucionin, duke i ftuar të japin ekspertizë e mendime për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit dhe përmirësimin e tyre.</p> <p>Pjesë aktive në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke ndihmuar në inicimin e propozimeve konkrete për përmirësim të kurrikulës në formularët përkatës të administruar nga Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, janë dhe bashkëpunëtorët e Kolegjit Universitar “LOGOS” në tregun e punës, specialistë nga institucionet ku studentët kryejnë praktikat profesionale, si dhe punëdhënësit e studentëve të diplomuar në KU “LOGOS”, me të cilët kolegji ruan marrëdhënie bashkëpunimi strategjike.</p> <p><i>Shtojca nr. 11: Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, Shtojca nr. 102: Të dhëna mbi ALUMNI në programin e studimit Master Profesional në Financë-Kontabilitet, Statistika punësimi analizë</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ vlerëson se institucioni përfshin njësitë mësimdhënëse, stafin dhe studentet në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

**Standardi VI.5**

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
------------------------	--------------------------------------




<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtarinë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>GVJ konstatoi se Kolegji Universitar “LOGOS”, në faqen e tij zyrtare ka të publikuar të plotë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- planin e tij strategjik të zhvillimit (<a href="http://www.kulogos.edu.al/al/strategicplan.html">http://www.kulogos.edu.al/al/strategicplan.html</a>);</li> <li>- vendimet e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit si vlerësim i jashtëm (<a href="http://www.kulogos.edu.al/al/external-evaluation.html">http://www.kulogos.edu.al/al/external-evaluation.html</a>)</li> <li>- informacion mbi veprimtarinë sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, mbi veprimtarinë e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (<a href="http://www.kulogos.edu.al/al/quality-assurance.html">http://www.kulogos.edu.al/al/quality-assurance.html</a>) dhe mbi veprimtarinë e Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Standardeve të Cilësisë (<a href="http://www.kulogos.edu.al/al/quality-assurance-committee.html">http://www.kulogos.edu.al/al/quality-assurance-committee.html</a>);</li> <li>- Kodin e Cilësisë (<a href="http://www.kulogos.edu.al/al/higher-education-quality-code.html">http://www.kulogos.edu.al/al/higher-education-quality-code.html</a>);</li> <li>- Politikën e Cilësisë (<a href="http://www.kulogos.edu.al/al/quality-policy.html">http://www.kulogos.edu.al/al/quality-policy.html</a>);</li> <li>- Manualin e Cilësisë (<a href="http://www.kulogos.edu.al/al/regulation-onquality-assurance.html">http://www.kulogos.edu.al/al/regulation-onquality-assurance.html</a>).</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Përgjegjësinë për komunikimin dhe publikimin e rezultateve të monitorimit, të vlerësimit dhe të akreditimit e kanë Kolegji Universitar “LOGOS” dhe njësitë kryesore.</p> <p>Rezultatet e akreditimit, sipas vendimeve përkatëse të Bordit të Akreditimit, rezultojnë të publikuara në faqen zyrtare të Kolegjit Universitar “LOGOS”. Rezultatet e monitorimit e të vlerësimit, si pjesë e raportit vjetor të institucionit rezultojnë të publikuara gjithashtu në faqen e tij zyrtare.</p> <p>Kolegji Universitar “LOGOS”, kujdeset të respektojë lirinë dhe etikën akademike, nëpërmjet një rregulloreje për mbrojtjen, përpunimin ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, në funksion të përmbushjes së misionit, vizionit dhe vlerave të tij.</p> <p><i>Shtojca nr. 7: Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ konstaton se Kolegji Universitar “LOGOS”, pas monitorimit sistematik të treguesve të cilësisë, nëpërmjet strukturave e autoriteteve përgjegjëse të angazhuara në monitorimet përkatëse, kujdeset që të shqyrtohen me kujdes rezultatet e vlerësimit dhe të hartohet një plan masash me qëllim përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> <p>Departamenti Financë-Kontabilitet evidenton nevojën për përmirësime e përditësime të programeve të lëndëve nga</p>



	<p>monitorimi i kritereve të kurrikulave dhe ndërmerr masat operative të nevojshme çdo fillim viti akademik për përmirësimet e duhura; Departamenti evidenton nevojën për zhvillimin e konsultimeve si orë plotësuese për rritjen e performancës së studentëve, për organizimin e leksioneve të hapura, seminareve e workshopeve, etj. (Shtojca nr. 88: Leksione të Hapura KU “Logos” 2019-2022).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se, Kolegji Universitar “LOGOS” vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, pasqyruar në rezultate gjithmonë e më të arrira, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kurrikul e përmirësuar, me në qendër studentin e bazuar në kompetenca dhe në kërkime;</li> <li>- përmirësimi i performancës së stafit akademik; me rritjen e numrit të stafit që kanë fituar grada shkencore ose janë në proces, me rritjen e numrit të mobiliteteve të stafit akademik etj.;</li> <li>- zgjerimi i rrjetit të bashkëpunëtorëve të Kolegjit Universitar “LOGOS”;</li> <li>- cilësia në rritje e studentëve të diplomuar;</li> <li>- cilësia në rritje e shërbimeve dhe kushteve infrastrukturore të ofruara nga Kolegji Universitar “LOGOS”;</li> <li>- rritja e kohëzgjatjes së akreditimit institucional dhe të programeve të studimit të ofruara nga Kolegji Universitar “LOGOS”.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e personelit dhe studentëve, për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit, GVJ vlerësoi se Kolegji Universitar “LOGOS” organizon veprimtari periodike me ta, ku mund të përmenden:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zhvillimi i seancave të informimit të studentëve mbi rëndësinë e zhvillimit të pyetësorëve të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies, treguesve të përdorur e mënyrës së interpretimit të tyre, nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</li> <li>- Bashkëpunimi me ASCAL për trajnimin e stafit dhe studentëve në lidhje me rëndësinë e zhvillimit të Sondazhit Kombëtar të Studentëve, si një nga mekanizmat kryesore të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë në vend;</li> <li>- Përfshirja në proceset e vlerësimit të brendshëm e të akreditimit, e stafit të ri akademik, me qëllim trajnimin e përfitimin e përvojës në këtë drejtim për krijimin e kulturës së cilësisë gjithmonë e më të gjerë në institucion.</li> </ul>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se:</p>




	<p>- Kolegji Universitar "LOGOS" ka përcaktuar qartë në rregulloren për sigurimin e cilësisë, përgjegjësitë dhe detyrat për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Në funksion të përmirësimit të cilësisë, institucioni ndërmerr masa të tilla si trajnime të stafit akademik apo rritje të mobiliteteve në kuadër të Erasmus +.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## **Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në "Financë Kontabilitet" të Institucionit të Arsimit të Lartë "Kolegji Universitar LOGOS"**

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm u realizua në kushtet e një bashkëpunimit plotë me strukturat e institucionit dhe bazuar në një informacion të plotë dhe transparent në përmbushje të objektivit sa më të plotë të vlerësimit të këtij programi.

### **❖ Pikat e forta dhe afirmime**

1. Programi i studimit me kohëzgjatje 1 vit akademik plotëson kërkesat e asaj pjese të studenteve potencial që dëshirojnë një kualifikim kryesisht profesional në fushën e financës dhe kontabilitetit.
2. Programi ofrohet nga një staf akademik i kualifikuar dhe me përvojë të gjatë akademike shkencore brenda dhe jashtë vendit.
3. KUL garanton qëndrueshmërinë financiare për mbështetjen financiare të nevojshme të procesit mësimor kërkimor jo vetëm nga tarifat e studenteve por kryesisht nga mbështetja financiare në formën e donacioneve nga Fondacioni LOGOS
4. Vendndodhja e përshtatshme e godinës së KUL ku zhvillohet procesi mësimor i këtij programi ofron lehtësira transporti dhe komunikimi për studentet e tij. Gjithashtu edhe orari i zhvillimit të mësimit pasdite është i përshtatshëm për studentet që janë në marrëdhënie pune.
5. KUL dhe FE janë aktive në marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura me universitete homologe të huaja, kryesisht të Greqisë duke mundur numër të kënaqshëm mobilitetesh për stafin.

### **❖ Pika të dobëta**

1. Numri i ulët i studenteve të regjistruar në këtë program rrezikon vazhdueshmërinë e programit në një të ardhme afatmesme.
2. Mungesa e një programi Master Shkencor në Finance Kontabilitet nuk u jep mundësi studenteve të këtij programi që të vazhdojnë studime më të thelluara në këtë fushë.

### **❖ Rekomandime**

1. Për të rritur karakterin profesional të një programi MP me kohëzgjatje 1 vit akademik brenda treguesit 20 % të ndryshimeve në program do të duhej të shtoheshin lëndët



karakterizuese si dhe numri i lendeve me zgjedhje bazuar në gjetjet dhe sugjerimet të shprehura në këtë raport.

2. Për të siguruar një numër optimal studentesh në këtë program institucioni duhet të realizojë një marketing intensiv me studentet potencial te interesuar në këtë program studimi me kohëzgjatje 1 vit akademik.
3. Për të rritur efikasitetin e procesit të aplikimit të njohurive profesionale në fushën e kontabilitetit dhe financës institucioni do të duhet të rinovojë laboratorët e informatike me kompjuterë të rinj me parametra teknike bashkëkohor.

### **Conclusions of the Evaluation of the Second Cycle Master Profesional in "Finance and Accounting" study program of the Higher Education Institution "College University of Logos"**


**The External Evaluation Report was carried out under the conditions of full cooperation with the institution's structures and based on complete and transparent information in order to fulfill the objective of the evaluation of this program as fully as possible.**

#### **❖ Strengths and affirmations**

1. The study program with a duration of 1 academic year meets the requirements of the potential students who want a mainly professional qualification in the field of finance and accounting.
2. The program is offered by a qualified academic staff with long academic scientific experience in the country and abroad.
3. KUL guarantees the financial sustainability for the necessary financial support of the teaching and research process not only regarding to student fees but mainly from financial support in the form of donations from the LOGOS Foundation
4. The convenient location of the KUL building where the teaching process of this program takes place offers transportation and communication facilities for its students. Also, the afternoon lesson schedule is suitable for students who are in a working relationship.
5. KUL and Faculty of Economy is active in cooperation agreements with foreign counterpart universities, mainly in Greece, enabling a satisfactory number of mobilities for the staff.

#### **❖ Weak points**


1. The low number of students enrolled in this program jeopardizes the continuity of the program in the medium term future.



2. The lack of a Master of Science program in Finance and Accounting does not give students in this program the opportunity to continue more in-depth studies in this field.

❖ **Recommendations**

1. In order to increase the professional character of an MP program with a duration of 1 academic year within the indicator of 20% of the changes in the program, the characteristic subjects as well as the number of optional subjects should be added based on the findings and suggestions expressed in this report.
2. To ensure an optimal number of students in this program, the institution should carry out intensive marketing with potential students interested in this study program with a duration of 1 academic year.
3. In order to increase the efficiency of the application process of professional knowledge in the field of accounting and finance, the institution will have to renew the computer labs with new computers with contemporary technical parameters.



**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË</b>			X	
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				X
<b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				X
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X

